



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju

PASQYRAT FINANCIARE

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Për periudhën e përfunduar deri me 31 Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	5
RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	6
1.1. POLITIKAT KONTABËL.....	7
1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE.....	7
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA	8
1.4. SHUMAT RAPORTUESE.....	8
1.5. VALUTA RAPORTUESE	8
1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	8
SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT	9
SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA.....	14
2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË.....	14
2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË (PUNËTORËT ME KONTRATË (JO NË LISTËN E PAGAVE).....	15
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME	16
3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME DHE KRAHASIME ME VITET PARAPRAKE	18
3.2. SHPALOSJE PËR PAGESAT E REALIZUARA PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA (KODI 13460)	19
3.3. PAGESA PERMBARIMORE	19
3.4. SHËNIM PËR SHPENZIMET E COVID-19.....	20
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE	20
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	21
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE	22
SHËNIMI 7 TJERA.....	22
SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE	23
SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE.....	23
SHËNIMI 10 TË HYRAT E DEDIKUARA.....	24
10.1. TË HYRAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË.....	25
SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE.....	26
SHËNIME TJERA 12.....	26
SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA	27

SHËNIMI 16 TË ARKËTUESHMET	27
SHËNIMI 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA	28
SHËNIMI 18 DETYRIMET KONTINGJENTE.....	29
SHËNIMI 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE	30
19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	30
19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO).....	31
19.3.3 STOQET.....	32
SHËNIMI 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA	32
SHËNIMI 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA.....	33
SHËNIMI 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM	33
SHËNIMI 23 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA	34
SHËNIMI 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA.....	34
SHËNIMI 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE.....	35
SHËNIMI 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE	36
SHËNIMI 27 RAPORT PËR NUMRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE	36
SHËNIMI 28 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA).....	38
 ANEKSI I PASQYRAVE FINANCIARE:	
TABELA 1 – PASQYRA KRYESORE	1
TABELA 2 – RAPORTI I PASURIVE.....	2
TABELA 3 – DETAJET E FATURAVE TË PAPAGUARA.....	3/7
RAPORTI I AKTIVITETEVE	1/37

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE**Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

		2020	2019	2018
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK	BKK	BKK
	Shënime	'000	'000	'000
BURIMET E FONDEVE - Pranimet				
Granti qeveritar		6,833	4,976	-
Të hyrat vetanake		-	-	-
Të hyrat e dedikuara		-	2,000	6,283
Të hyrat nga AKP		-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve		-	-	-
Klauzola e investimeve		-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	-
	GJITHSEJ	6,833	6,976	6,283
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - Pagesat				
Operacionet				
Paga dhe rroga	2	5,348	5,226	4,620
Mallra dhe shërbime	3	1,368	1,623	1,446
Shpenzime komunale	4	50	64	74
	GJITHSEJ	6,766	6,913	6,140
Transferet				
Transfere dhe subvencione	5	33	40	53
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	34	23	90
Pagesa tjera				
	7	-	-	-
	GJITHSEJ	6,833	6,976	6,283

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

		Janar – Dhjetor 2020				2019	2018
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
Shënime		A '000	B '000	C '000	D=A/B (%)	E '000	F '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	8	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	9	-	-	-	-	-	-
*Të hyrat e dedikuara	10	-	-	-	-	1,036	6,494
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	-	-	-	-	-	-
Tjera	12	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		-	-	-	-	1,036	6,494
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Paga dhe rroga	2	5,348	5,349	5,323	100%	5,226	4,620
Mallra dhe shërbime	3	1,368	1,515	2,578	90%	1,623	1,446
Shpenzime komunale	4	50	55	98	91%	64	74
Transfere dhe subvencione	5	33	33	40	97%	40	53
Shpenzime kapitale	6	34	34	80	100%	23	90
Tjerrat	7	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		6,833	6,986	8,120	98%	6,976	6,283

*AKP nuk planifikon të hyra. AKP vetëm depoziton mjetet (Të Hyrat e Dedikuara) në Fondin e Konsoliduar të Kosovës për të mbuluar buxhetin e aprovuar me Ligjin e Buxhetit. AKP, nuk planifikon të hyrat si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë. Detajet janë të shpalosura në shënimin nr. 10 dhe nr.23.

1.1. POLITIKAT KONTABËL

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik si dhe rregullores të Ministrisë së Financave të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Rregullorja i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është një organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-080, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L-115 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës si dhe ndryshim plotësimin me ligjin Nr. 06/L-023.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t’i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve) nëpërmjet të metodave të "spin off-it" dhe shitjeve të aseteve përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore. Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2020**. Buxheti i AKP-së gjatë periudhës raportuese është financuar nga **Granti Qeveritar (GQ)**.

Të hyrat e Dedikuara (THD) - Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080 **janë:** *Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFPP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.*

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar të gjitha aktivitetet administrative dhe operative për vitin fiskal 2020.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Në zbatim të SNKSP pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.4. SHUMAT RAPORTUESE

Shumat raportuese nga formati i pasqyrave financiare nga paragrafi: 2 deri te paragrafi 15 janë në `000 (mijë) Euro (€) dhe nga 16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.5. VALUTA RAPORTUESE

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€).

1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare autorizohen në datën e nënshkrimit të deklaratës së Pasqyrave Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zyrtari Kryesore Financiar.

SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFPP						Grande t e përcakt uar të donato rëve € '000	Burime tjera të financimi t € '000	Buxheti përfundi mtar SIMFK € '000
	Buxheti Fillestar (Ligji Nr. 06/L- 133) € '000	Ndryshimet buxhetore I sipas ligjit nr. 07/L-014 buxhetit të rishikuar € '000	Ndryshimi buxhetore I sipas vendimit të Qeverisë me nr. 01/46 € '000	Ndryshimi buxhetore II sipas vendimit të Qeverisë me nr. 09/50 € '000	Ndryshi mi IV € '000	Të hyrat vetanake € '000			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000			
Hyrjet									
Të hyrat tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Grandet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Daljet									
Paga dhe rroga	5,324	-	-	25	-	-	-	-	5,349
Mallra dhe shërbime	2,578	(880)	(142)	(41)	-	-	-	-	1,515
Shpenzime komunale	98	(40)	-	(3)	-	-	-	-	55
Transfere dhe subvencione	40	-	-	(7)	-	-	-	-	33
Shpenzime kapitale	80	(40)	(40)	34	-	-	-	-	34
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjerat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	8,120	(960)	(182)	8	-	-	-	-	6,986

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2020 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Shkurtime buxhetore sipas ligjit për rishikim gjysmë vjetor dhe dy vendimet e qeverisë përkatësisht vendimi nr. **01/46 dhe 09/50** është bërë si rezultat i situatës aktuale buxhetore të shkaktuar nga pandemia Covid -19 e cila ka rezultuar në ndërrimin e prioriteteve qeveritare dhe Kuvendit rreth buxhetit për organizatat buxhetore. Shkurtesat buxhetore janë bërë përtej kursimeve që AKP ka paraqitur dhe një pjesë e obligimeve ka mbetur pa u paguar për vitin fiskal 2020. Këto obligime do të jenë barrë e buxhetit të vitit 2021.

Vlera e tërësishme që AKP ka paraqitur për kursime është EUR 316 mijë (të gjitha nga mallrat dhe shërbimet), mirëpo siç është paraqitur në tabelën më lartë totali i shkurtesave të Buxhetit të AKP'së është EUR 1,134. Këto shkurtesa janë bërë me ligjin për ndryshimin e buxhetit nga Kuvendi si dhe dy vendimet të Qeverisë.

Vlera e kursimeve të prezantuara nga AKP prej EUR 316 është si më poshtë:

	1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Përshkrimi	Administrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
Mallra dhe shërbime	(32)	(66)	(29)	(105)	(20)	(64)	316

Ndërsa shkurtesat buxhetore nga Kuvendi dhe Qeveri janë paraqitur në tabelat e mëposhtme sipas kategorive ekonomike për programet buxhetore.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2020 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- Ndryshimet buxhetore i sipas ligjit nr. 07/L-014 të buxhetit të rishikuar

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Administrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	(410)	(30)	(40)	(200)	(120)	(80)	(880)
3	Shpenzime komunale	(40)	-	-	-	-	-	(40)
5	Transfere dhe subvencione	(40)	-	-	-	-	-	(40)
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	(490)	(30)	(40)	(200)	(120)	(80)	(960)

- Ndryshimi buxhetore I sipas vendimit të Qeverisë me nr. 01/46 të datës 25 nëntor 2020

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Administrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	(79)	-	-	(63)	-	-	(142)
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	(40)	-	-	-	-	-	(40)
	Gjithsej	(119)	-	-	(63)	-	-	(182)

- **Ndryshimi buxhetore i sipas vendimit të Qeverisë me nr. 09/50 të datës 21 dhjetor 2020**

Si rrjedhojë e këtyre reduktimeve të prezantuar në tabelat më lartë, në programin e Administratës Qendrore nuk kemi pasur mjete për ti mbuluar shpenzimet për shërbime kontraktuese tjera deri në fund të vitit fiskal 2020 dhe mundësia e vetme kishte mbetur që të bëjmë kërkesë për transfer nëpërmjet programeve buxhetore.

Gjithsej shuma e transferit në programin e Administratës Qendrore që kemi kërkuar është EUR 75,990 dhe nuk ka tejkaluar vlerën 15% nga ndarjet buxhetore të programeve nga të cilat merren mjetet. Nëpërmjet tabelës të mëposhtme është paraqitur kërkesa transferove nëpërmjet programeve buxhetore.

Programet ku merren mjetet		Programi ku transferohen mjetet	
Kodi dhe programi	Shuma	Kodi dhe programi	Shuma
23200 – Riorganizimi dhe Administrimi	(31,290)	22900 – Administrata Qendrore	75,990
22600 - Privatizimi	(34,270)		
23100 - Auditimi	(4,470)		
23000 – Departamenti Ligjor	(5,960)		
Gjithsej:	(75,990)	Gjithsej:	75,990

Mjetet e transferuara në programin buxhetor Administrata Qendrore pre EUR 75,990 përfshijnë vlerën prej EUR 42,510 për mallra dhe shërbime si dhe vlerën prej EUR 33,480 shpenzimet kapitale. Ndërsa mjetet që janë transferuar nga programet janë të gjitha nga kategoria mallra dhe shërbime.

Mirëpo, këto transfere nëpërmjet programeve buxhetore nuk ishin bërë, përkundrazi ishin shkurtuar sipas vendimit nr. 01/46 të datës 25 nëntor 2020. Pas kësaj, AKP vazhdimisht ka dërguar kërkesa që të shqyrtohet mundësia që mjetet të kthehen për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve që ishin më se të nevojshme për mbarëvajtjen e aktiviteteve të AKP'së. AKP argumentonte se shkurtesat buxhetore sipas vendimit nr. 01/46 të datës 25 nëntor 2020 janë bërë jo në mënyrën e duhur duke marrë mjete nga programi buxhetor i Administratës dhe në anën tjetër kishin mbetur ende mjete në programet tjera buxhetore pas ri-planifikimit buxhetor si pasojë e ndërprerjes të aktiviteteve nga Covid-19.

Më në fund, më 21 dhjetor 2020 sipas vendimit nr. 09/50, mjetet janë alokuar në programin buxhetor të Administratës Qendrore. Kryesisht mjetet e transferuar në Administratë Qendrore ishin marrë nga programet tjera buxhetore të AKP. Përveç kësaj, me këtë vendim janë transferuar mjete shtesë për kategorinë paga dhe mëditje në shumën prej EUR 25 mijë për të cilat kishin kërkuar sipas shkresës më datë 9 nëntor 2020.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur ndryshimet sipas vendimit 09/50 të datës 21 dhjetor 2020.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2020 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Administrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	25	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	45	(26)	(27)	-	5	(39)	(42)
3	Shpenzime komunale	(2)	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	(6)	-	-	(6)
6	Shpenzime kapitale	33	-	-	-	-	-	33
	Gjithsej	101	(26)	(27)	(6)	5	(39)	(8)

SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA

	2020					2019	2018
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final	Krahasimi		
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave	4,152	4,152	-	4,152	100%	4,041	3,824
Pagesa për sindikatë	-	-	-	-	-	-	-
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-	-	-	-	-	-	-
*Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	329	329	-	329	100%	340	-
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	390	390	-	390	100%	379	356
Kontributi pensional-punëtori	239	239	-	239	100%	233	220
Kontributi pensional-punëdhënësi	239	239	-	239	100%	233	220
PAGA DHE RROGA -	5,349	5,349	-	5,349	100%	5,226	4,620

2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË

Numri i punëtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2020 është gjithsej 257 zyrtarë, duke përfshirë edhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Shih edhe në shënimin shpjegues nr. 25.

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratës Tatimore të Kosovës.

Më poshtë janë paraqitur e ndryshimet/lëvizjet si dhe raste tjera gjatë vitit 2020 për stafin e AKP-së.

- REKRUTIMET:** Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka vazhduar me dy (2) procedura të rekrutimit të cilat janë pezulluar në vitin 2019 pas pezullimit të të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik nga Gjykata Kushtetuese.
- DORËHEQJE:** Për arsye personale tre (3) punonjës kanë ofruar dorëheqje.
- TRANSFERET:** Dhjetë (10) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme dhe dy (2) punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme.
- PEZULLIM I DAKORDUAR:** Dy (2) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.

5. **PENSIONIM:** Një (1) punonjës është pensionuar me rastin e përmbushjes së moshës 65 vjeçare.
6. **PUSHIM LEHONIE:** 6 (gjashtë) zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë.
7. **USHTRUES DETYRE:** Gjatë vitit 2020, 16 (gjashtëmbëdhjetë) zyrtarë janë caktuar ushtrues detyre në periudha të ndryshme. Arsytet dhe nevojat për caktim të ushtrues detyre kryesisht kanë të bëjnë me zëvendësimin e pozitave të mbetura të paplotësuara pas pezullimit të dakorduar të pozitave dhe krijimit të pozitave të reja sipas strukturës së re organizative.

2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË (PUNËTORËT ME KONTRATË (JO NË LISTËN E PAGAVE))

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe kompensohet sipas Rregullores për Kompensimin e Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Prej vitit 2008 e deri në fund të vitit 2018, shpenzimet për kompensimin e Bordit të Drejtorëve janë realizuar nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime nga kodi ekonomik 13440 "Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse". Prej fillimit të vitit 2019, (sipas rekomandimit të zyrës së Auditorit Gjeneral) shpenzimet e lartpërmendura kanë filluar të buxhetohen dhe të realizohen pagesat nga kategoria Paga dhe Mëditje nga kodi ekonomik 11400 "Punëtorët me Kontratë jo në listën e pagave".

Për periudhën raportuese, pagesat në vlerën neto prej EUR 328,724 të realizuara ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së dhe raste tjera, pasqyrohen si më poshtë:

		1	2	3	4=1+2+3
Nr.	Përshkrimi	Pagesat neto	Tatimet	Kontributet pensionale (5+5%)	Gjithsej
1	Për mbledhje të Bordit	273,864	27,981	22,311	324,157
2	Për komisionet e Bordit	3,719	413	434	4,567
	Gjithsej	277,583	28,394	22,745	328,724

Pagesat e realizuara gjatë periudhës raportuese kanë të bëjnë me aktivitetet e mëposhtme:

1. Mbledhjet e Bordit – 17 mbledhje (11 mbledhjet të rregullta dhe 6 mbledhje të jashtëzakonshme);
2. 3 mbledhje/takime të Komitetit të Auditimit.

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me natyrën e shpenzimeve.

Përshkrimi	2020				Krahasimi	2019	2018
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		€ '000	€ '000
Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	4	5
Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	3	6
Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	0
Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	2	3
Shpenzimet për internet	19	19	-	19	100%	12	3
Shpenzimet e telefonisë mobile	17	17	-	17	100%	46	57
Shpenzimet postare	-	-	-	6	0.00%	3	2
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	-	-	-	-	-	8	7
Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	-	-	-	-	-	-	2
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	-	-	-	-	-	22	219
Shërbime shtypje - jo marketing	1	1	-	1	100%	1	3
Shërbime Kontraktuese Tjera	659	659	-	726	91%	625	344
Shërbime Teknike	4	4	-	14	29%	5	4
Mobile (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	5	7
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	13	13	-	13	100%	-	-
Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	7	7	-	7	100%	47	48
Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	3	3	-	4	75%	3	2
Furnizime për zyrë	14	14	-	15	93%	23	16
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	8	8	-	8	100%	11	11

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2020 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Furnizime pastrimi	7	7	-	7	100%	8	6
Furnizim me veshmbathje	-	-	-	-	-	-	7
Nafte për ngrohje qendrore	37	37	-	37	100%	35	46
Derivate për gjenerator	-	-	-	-	-	4	3
Karburant për vetura	17	17	-	17	100%	28	25
Vaj	-	-	-	-	-	0	1
*Avance	-	-	-	-	-	-	-
Regjistrimi i automjeteve	3	3	-	3	100%	3	2
Sigurimi i automjeteve	8	8	-	8	100%	11	11
Taksa komunale e regjistrimit të automjeteve	-	-	-	-	-	0	0
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	28	28	-	29	97%	32	23
Mirëmbajtja e ndërtesave	5	5	-	7	71%	3	1
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informativë	16	16	-	16	100%	15	13
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	12	12	-	12	100%	17	11
Qiraja për ndërtesa	224	224	-	226	99%	245	243
Qiraja për pajisje	-	-	-	-	-	1	5
Qiraja për përdorime tjera hapësinore	189	189	-	189	100%	161	179
Furnizime mjekësore	2	2	-	3	67%	-	-
Reklamat dhe konkurset	-	-	-	-	-	6	1
Botimet e publikimeve	-	-	-	-	-	0	-
Shpenzimet për informim publik	72	72	-	115	63%	221	129
Drekat zyrtare	3	3	-	4	75%	5	3
Shpenzime-vendimet e gjykatave	-	-	-	12	-	8	1
MALLRA DHE SHËRBIME	1,368	1,368	-	1,515	90%	1,623	1,446

- Avancë ka qenë e buxhetuar për paranë e imët që është mbajtur në arkë. Të gjitha pagesat e bëra në vlerën **EUR 1,112.62** janë kategorizuar sipas planit kontabël, kurse bilanci tani është zero pas kthimit të mjeteve të pashpenzuara.

3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME DHE KRAHASIME ME VITET PARAPRAKE

Në përgjithësi për kategorinë mallra dhe shërbime, shpenzimet do të ishin më të mëdha po që se do të realizohej ky buxhet në bazë të planifikimit. Por, situata aktuale e shkaktuar nga pandemia globale Covid-19 ka rezultuar në rrjedhën normale të aktiviteteve të AKP'së si pasojë e kufizim/ndalim qarkullimi si masa të ndërmarra në nivel vendi nga Qeveria e Kosovës.

Gjithsesi, në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nënvija buxhetore për performancën si dhe krahasime me vite të kaluara.

- **Shpenzimet e telefonisë mobile**

Shpenzimet e telefonisë mobile në vitin 2020 janë shpenzuar 17 mijë që është 63% më pak se në vitin 2019 që ishin shpenzuar EUR 46 mijë. Kjo ulje e kostos të shpenzimeve të telefonisë mobile është si rezultat i ndryshimit të politikës për stafin e AKP'së për shfrytëzimin e përdorimit të numrave zyrtar të telefonave mobil.

- **Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare**

Gjatë viti fiskal 2020, nuk ka pasur shpenzime të udhëtimit zyrtarë jashtë vendit.

- **Shpenzimet për informim publik.**

Arsyeja e mos-shpenzimit në tërësi të shumës së planifikuar gjatë viti fiskal 2020, është sepse AKP-ja nuk ka mundur të zhvilloj aktivitetin e shitjeve sipas planifikimit vjetor që ka pasur, për arsye të vendim të marrë nga qeveria e Kosovës për ndalimin e përkohshëm të shitjeve të NSH-ve nga muajin mars 2020.

- **Shërbime kontraktuese tjera (Për NSH-të që janë nën Administrim Direkt).**

Arsyeja e mos shpenzimit të buxhetit për ndërmarrjet në Administrim Direkt është se planifikimi ka qenë i paraparë që pas vendosjes të ndonjë ndërmarrje në AD të angazhohen si ofrues të shërbimeve edhe roje për të ruajtur hapësirat e kësaj ndërmarrje, por pasi që ndërmarrjet kanë arritur që të realizojnë të hyra vetanake atëherë shpenzimet e krijuara janë mbuluar nga këto të hyra.

- **Aktivitete vështruese kadastrale.**

Mjetet nuk janë shpenzuar në tërësi për arsye se gjatë shitjeve të vitit 2020 nuk ka pasur shitje për arsye të vendimit të marrë nga Qeveria e Kosovës për ndalës të përkohshme të valëve të shitjes.

3.2. SHPALOSJE PËR PAGESAT E REALIZUARA PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA (KODI 13460)

Sa i përket pagesave, në mënyrë që lexuesi të ketë një pasqyrë më të qartë, do të pasqyrohen më në detaje në tabelat e mëposhtme, pasi që brenda një kategorie (kodit ekonomik të shpenzimeve) janë realizuar pagesa për shërbime të ndryshme dhe që kanë vlera të mëdha.

Shërbimet kontraktuese tjera në shumën prej **EUR 659,386** përfshinë pagesat si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
Pagesat ndaj BSPK-së si kompensim për shpenzimet mujore lidhur me 20% e punëtorëve	47,803	7%
Shërbimet e sigurimit të Zyrave të AKP-së ndaj operatori ekonomik "Policia e Kosovës"	213,333	32%
Sigurimi i mbulimit të përgjegjësisë profesionale për drejtoret e bordit dhe zyrtaret e AKP-së	59,876	9%
Shpenzime për përkthim të dokumenteve zyrtare	5,040	1%
Pagesat e trustit pensional dhe tatimit në të ardhura personale për Ofruesit e Shërbimeve	29,606	4%
Takimi ekzekutiv i organizuar nga Menaxhmenti i AKP-së	12,420	2%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për ruajtjen e aseteve të NSh-ve para se të hyjnë në likuidim	54,862	8%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për shërbimet e tjera administrative në ZQ dhe ZR	172,644	26%
Pagesat për marrje me qira të veturave për shfrytëzim për nevoja të AKP-së	17,926	3%
Shpenzime për regjistrimin e aseteve të AKP-së	43,680	7%
Shpenzime për pagesë të çertifikata për server SSL për tre vite	2,196	0%
GJITHSEJ PAGESA TE REALIZUARA NË KATEGORINË "SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA"	659,386	100%

3.3. PAGESA PERMBARIMORE

Me datën 29 korrik 2020, Departamenti i Thesarit ka bërë ekzekutimin përmbarimore P.nr.734/19 në vlerën prej EUR 154,076.70 me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1848/19, mirëpo pas vërejtjes nga ana e AKP'së se këto mjete sipas nenit 18 të ligjit nr. 04/L-034, përkatësisht paragrafit 1, 2 dhe 3, kjo çështje i atribuohet fondeve/llogarive në mirëbesim të ndërmarrjeve shoqërore pranë Bankës Qendrore të Kosovës, mjetet janë kthyer në Thesar në vijën buxhetore të AKP-së dhe janë tërhequr nga fondet në mirëbesim të AKP'së në BQK.

3.4. SHËNIM PËR SHPENZIMET E COVID-19

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
Furnizime për zyrë	254	4.10%
Furnizime mjekësore	1,560	25.21%
Mirëmbajtja e ndërtesave	4,374	70.69%
GJITHSEJ PAGESA TE REALIZUARA PËR COVID-19	6,188	100%

SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar për shërbime komunale është **EUR 98,000.00**, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Pagesat e shërbimeve publike përfshijnë të gjitha pagesat e bëra për zyrën Qendrore dhe zyrat regjionale të AKP-së.

	2020					2019	2018
Përshkrimi	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THD € '000	Buxheti Final € '000	Krahasimi %	Pagesat € '000	Pagesat € '000
Rryma	40	40	-	45	89%	49	52
Uji	2	2	-	2	100%	5	6
Mbeturinat	3	3	-	3	100%	3	3
Ngrohja Qendrore	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet telefonike	5	5	-	5	100%	6	13
Pagesa-vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-
SHPENZIMET KOMUNALE	50	50	0	55	91%	64	74

SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar për subvencione dhe transfere është **EUR 40,000.00**, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Ky buxhet është i dedikuar për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

Mjetet nga Subvencionet shfrytëzohen për pagesën e menaxhmentit dhe drejtorëve të bordeve menaxhuese të Ndërmarrjeve në Administrim Direkt, të cilat nuk kanë mundësi për të bërë pagesën nga mjetet që realizojnë ndërmarrjet.

Përshkrimi	2020					2019	2018
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THD € '000	Buxheti Final € '000	Krahasimi %	Pagesat € '000	Pagesat € '000
Subvencione për entitetet publike	33	33	-	34	97%	40	53
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)	-	-	-	-	-	-	-
Subvencione për entitetet jopublike	-	-	-	-	-	-	-
Menaxhimi i burimeve të ujitjes për bujqësi	-	-	-	-	-	-	-
Diversifikimi i fermave	-	-	-	-	-	-	-
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	33	33	0	34	97%	40	53

SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar për shpenzime kapitale është **EUR 80,000.00**, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Mjetet kanë qenë të destinuara për projektin “blerja e pajisjeve brenda shpenzimeve kapitale (Pajisje të Teknologjisë Informative)”.

Gjatë viti fiskal nga kjo kategori ekonomike, me rishikim të buxhetit kemi pasur shkurtime në vlerë prej EUR 40,000, dhe me vendim të Qeverisë të Kosovës kemi pasur edhe një shkurtesë në vlerën prej EUR 6,520.00.

Projekti është realizuar dhe vlera e faturës EUR 33,480 të pranuar nga operatori ekonomik.

	2020					2019	2018
	Gjithsej Pagesat			Buxheti Final		Pagesat	Pagesat
		GQ	THD		Krahasimi		
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Pajisje të teknologjisë informative	34	34	-	34	100%	23	90
Shpenzime kapitale	34	34	0	34	100%	23	90

SHËNIMI 7 TJERA

AKP-ja pranon depozitat e ofertuesve për pjesëmarrje në tender si depozitë e sigurisë. Këto mjete kthehen në rastin kur këta ofertues nuk janë fitues. Rastet kur ofertuesit janë fitues të përkohshëm mirëpo nuk arrijnë t’i plotësojnë kriteret tjera si p.sh. realizimin e pagesës të shumës blerëse brenda afatit kohor, depozitat e tyre konfiskohen dhe njihen si të hyra. Rastet e tilla paraqiten si të hyra në *nr. 10 të shënimeve shpjeguese*. Detaje lidhur me këto të Hyra janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

	2020	2019	2018
Natyrë e pagesës	€ '000	€ '000	€ '000
Depozitat e lojërave të fatit	0	0	0
Depozitat e Komisionit Rregullativ	0	0	0
Depozitat e Ministrisë së Drejtësisë	0	0	0
Depozita tjera	0	0	0
Gjithsej	0	0	0

SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE

Nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të Agjencisë.

Përshkrimi	Shënime	2020	2019	2018	% e totalit nga 2019	% e ndryshimit nga 2018
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat tatimore 1						
Të hyrat tatimore 2						
Të hyrat tatimore 3						
Të hyrat tatimore 4						
GJITHSEJ						

SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE

Të hyrat nga licencat, të hyra nga pasuritë, të hyra nga shitja e shërbimeve, gjoba dhe taksa të aplikueshme nga AKP-ja, në këtë kategori, për këtë periudhë raportuese nuk ka të hyra.

Të gjitha të hyrat e realizuara që trajtohen dhe janë për AKP-në, njihen si të hyra të dedikuara. Për detaje, *referojuni shënimit shpjegues nr. 10*.

Përshkrimi	Shënime	2020	2019	2018	% e totalit nga 2019	% e ndryshimit nga 2018
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat nga taksa 1						
Të hyrat nga dënimet-gjoba						
Të hyrat nga licencat						
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve						
Të hyrat nga inspektimi						
Të hyrat nga interesi bankar						
Të hyrat nga ndryshimi i pozicionit të kursit						
Të hyrat nga pasuria						
GJITHSEJ						

SHËNIMI 10 TË HYRAT E DEDIKUARA

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080:

Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqindje (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.

Të hyrat e realizuara vetëm për periudhën raportuese janë EUR 1,337,855

Përshkrimi	Shënime	2020	2019	2018	% e totalit	% e ndryshimit
		€ '000	€ '000	€ '000	2019	2019
ati1 - Interes i fituar mbi tarifën administrative të Agjencisë	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati2 - 5% e shitjeve nga likuidimi	PF - Fondet në mirëbesim	1,163	1,357	988	87.07%	(14.30)%
ati3 - 5% nga shitja prej privatizimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	(3)	0.00%	0.00%
ati4 - 5% e të ardhurave të komercializimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati5 - 5% e të ardhurave të tjera nga NSH nëse ka	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati6 - nga Fondi Rezervë i AKP-së	PF - Fondet në mirëbesim	95	91	(13)	7.11%	(4.40)%
ati7 - nga Llogaria për Deponimin e Ofertës për Privatizim	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati8 - nga Tarifa për Dorëzimin e Ofertës për Privatizim	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati9 - nga Llogaria për Deponimin e Ofertës në Likuidim	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati10 - nga Tarifa për Regjistrim për Likuidim	PF - Fondet në mirëbesim	78	306	105	5.84%	(74.51)%
ati11 - 5% e interesit në Llogarinë Bankare të Likuidimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
ati12 - nga Llogaria për Deponimin e Shqyrtimit të Likuidimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
Inkasimet nga përdorimi i telefonisë mobile dhe tjera	Shënimi nr 21.	-	-	-	0.00%	0.00%
Inkasimet e kapitalit themeltar të paguar më parë	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.00%
	GJITHSEJ	1,336	1,754	1,077	100%	(23.83)%

PF- Fondet në mirëbesim janë të prezantuara në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim, përkatësisht të hyrat në llogarinë bankare të tarifës administrative që Agjencia Kosovare administron në Bankën Qendrore të Kosovës.

Nga tërë procesi 2003 - 20 për të gjitha shitjet dhe të hyrat e tjera (konfiskime të BID depozitave dhe tarifa për pjesëmarrje të tenderëve) gjithsej të hyrat e realizuara në llogarinë bankare që AKP-ja e administron janë **EUR 47,805,880**. Këto mjete janë inkasuar në llogarinë bankare të tarifës administrative të cilën AKP-ja e menaxhon dhe administron.

Ndërsa sa i përket transferimit të mjeteve në llogarinë e tarifës administrative të cilën Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave e administron të dhënat janë paraqitur si më poshtë.

10.1. TË HYRAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur shumat e transferuara për buxhetet e viteve 2011 – 2019 sipas vlerës së buxhetuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri më tani shumat e transferuar për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative për buxhetet e AKP-së janë EUR 45,777,947.

NR.	PËRSHKRIMI DHE DATA E TRASFERËVE	PËR BUXHETIN E VITIT	GJITHSEJ
1	Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
2	Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
3	Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
4	Transfer shtesë me 18 Nëntor 2012	2014	2,300,000
5	Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
6	Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
7	Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
8	Transferet shtesë gjatë vitit 2018	2018	6,493,706
9	Transferet shtesë gjatë vitit 2019	2019	1,036,241
10	Transferet shtesë gjatë vitit 2020	2020	0.00
GJITHSEJ PAGESAT			45,777,947

Për vitin 2020, buxheti i AKP'së është financuar tërësisht nga Granti Qeveritar. Rrjedhimisht siç është paraqitur në tabelën më lartë nuk kemi transferuar mjete apo nuk kemi financim nga të hyrat e dedikuara.

Mjetet e paraqitura që janë shpalosur më lartë, nga pika katër deri në nëntë, janë transferuar vetëm për ato shuma shtesë të nevojshme për të mbuluar buxhetin e periudhës fiskale, pasi që kemi pasur mjete të pa shpenzuar dhe këto mjete sipas Ligjit të Buxhetit dhe të AKP-së barten në vitin e ardhshme.

Lidhur me bartjen e tepricave dhe transferimin e mjeteve shtesë për buxhetin e të hyrave të dedikuara Për më tepër, shih shënimin shpjegues nr. 23.

AKP-ja nuk planifikon të hyra si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Thesari i Ministrisë së Financave është kërkuar që të paraqitet si e hyrë vetëm transferi bankar në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit.

SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar Grante nga Donatorët.

			2020	2019	2018
			€ '000	€ '000	€ '000
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Gjithsej			0.00	0.00	0.00

SHËNIME TJERA 12

Agjencia nuk është e përfshirë në pranim të depozitave të natyrave tjera.

	2020	2019	2018
	€ '000	€ '000	€ '000
Natyrë e pranimi			
Depozitat e lojërave të fatit	0	0	0
Depozitat e Komisionit Rregullativ	0	0	0
Depozitat e Ministrisë së Drejtësisë	0	0	0
Depozita tjera	0	0	0
Gjithsej	0	0	0

SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA

Agjencia nuk është e përfshirë në pranim të depozitave të natyrave tjera.

	2020	2019	2018
	€ '000	€ '000	€ '000
Natyra e pranimi			
Pagat dhe mëditjet	0	0	0
Mallrat dhe Shërbimet	0	0	0
Shpenzimet Komunale	0	0	0
Subvencione dhe Transferet	0	0	0
Gjithsej pagesa nga palët e treta	0	0	0

SHËNIMI 16 TË ARKËTUESHMET

		2020	2019	2018
Kodi ekonomik	Përshkrimi	€	€	€
0000	Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile	0.00	0.00	2,281
	GJITHSEJ	0.00	0.00	2,281

SHËNIMI 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	2020		2019		2018	
		< 30 ditë	> 30 Ditë	< 30 ditë	> 30 Ditë	< 30 ditë	> 30 Ditë
11	Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-
13	Mallra dhe shërbime	74,060.98	1,065.99	72,535.52	5,544.97	49,713.00	-
14	Shpenzime komunale	6,977.41	611.05	5,411.98	110.18	6,673.00	-
20	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-
30	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		81,038.39	1,677.04	77,947.50	5,655.15	56,386.00	-

Në shumat e obligimeve të papaguara janë të paraqitura sipas datës së pranimit të faturave, për të cilat është raportuar në Thesar të Ministrisë së Financave si dhe për shpenzimet e vitit 2020, fatura të cilat janë pranuar në vitin 2020 dhe rastet tjera të njohura për AKP-në (fatura që ende nuk janë pranuar). Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 4.

Pjesa më e madhe e faturave që janë paraqitur si detyrime në tabelë janë pranuar gjatë muajit janar 2021, po ashtu kemi edhe fatura që janë pranuar pas përfundimit të afatit për pagesa (24 dhjetor 2020), afat i përcaktuar nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave. Gjithsej këto obligime janë rreth EUR 82 mijë, nga vlerë e përgjithshme e detyrimeve vetëm vlera prej EUR 1,700.40 janë fatura që i kanë tejkaluar afatin e pagesave prej 30 ditëve.

SHËNIMI 18 DETYRIMET KONTINGJENTE

Detyrimet kontingjente të AKP-së të cilat kanë të bëjnë me: pagat, kontraktimet, mallrat, shërbimet si dhe çështje të tjera lidhur me operimin e përditshëm të Agjencisë (aktivitetet e AKP-së që financohen nga Buxheti i Kosovës -të hyrat e dedikuara për AKP-në- dhe donatorët):

Natyra e detyrimeve kontingjente	Arsyeja për detyrime	2020	2019	2018
		€	€	€
Pezullim nga puna për punëtorët të AKP-së	Llogaritja e 50% të pagës bruto në përputhje me ligjin shërbyesit civil (duke e përfshirë edhe 5% e punëdhënësit)	362,541	311,152	212,057
Shërbime për mirëmbajtje të fotokopjes	EUR 215.86 janë të papaguara, një pjesë të mjeteve nuk e mbulon kontrata dhe gabim teknik i shënuar në faturim F-15-2295	(216)	216	216
Shërbime për mirëmbajtje të fotokopjes	Fatura me nr. SH-1089/2016 lidhur me shërbimet e fotokopjimit është në vlerë prej € 1,232.09, janë paguar vetëm € 600. Pjesa prej € 632.09 nuk ka pasur mbulesë në kontratë.	(632)	632	632
*Shpalljet në gazeta	Fatura të të papaguara që më parë janë ndalur për shkak të tejkalimit të vlerës të kontratës, por që blerësi i ri i kompanisë nuk ka shprehur interesin që të pranojë këto pagesa. Këto obligime në pasqyrat financiare 2018 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente.	(269)	269	-
*Shërbime të shpejta postale	Fatura të pranuar/papaguara që më parë janë ndalur për shkak se këto shërbime nuk kanë pasur kontratë. AKP ka shprehur gatishmëri që të trajtohen për pagesë mirëpo pala/operatori nuk ka shprehur interesim të bashkëpunimit që këto raste të procesohen për pagesë	(252)	252	-
Shërbimet e përkthimit	Fatura me nr. IN2413 lidhur me shërbimet për përkthime është në vlerë prej € 654.79, janë paguar € 474.39. Për pjesën prej € 180.4 është tejkaluar vlera e kontratës.	(180)	180	180
Gjithsej		360,998	312,701	213,085

Rrjedha e ndryshimeve gjatë vitit 2019 është sipas tabelës të mëposhtme:

PËRSHKRIMI	Vlera
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 Dhjetor 2019	312,701
Llogaritja shtesë e 50% e pagës deri në vendim të gjykatës për zyrtarët që janë në procedurë gjyqësore	+ 51,389
Shlyerje e detyrimeve kontingjente për rastet e shërbimeve për mirëmbajtje të fotokopjimit, shpalljeve në gazeta si dhe shërbime postale. Këto raste ka vite që janë mbetur pa u trajtuar me vullnetin e furnitorëve	- (1,549)
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 dhjetor 2020	= 362,541

SHËNIMI 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE

19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)

	2020	2019	2018
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Ndërtesat	112,028	115,914	119,800
Pajisjet	56,046	83,037	101,883
Automjetet	8,848	22,119	38,107
Pasuri i paprekshme	18,326	-	-
48	13250	Telekomi i Kosoves Vala Fikse	4-Nov-20	550020236/2054	Shpenzimet e telefonise fikse, Tetor 2020	476.61	Fatura eshte pranuar me 22 dhjetor 2020	Administrata Qendrore	AQ5	janar - shkurt 2021	
49	13250	Telekomi i Kosoves Vala Fikse	2-Dec-20	550020236/2060	Shpenzimet e telefonise fikse, Nentor 2020	463.11	Fatura eshte pranuar me 22 dhjetor 2020	Administrata Qendrore	AQ5	janar - shkurt 2021	
50	13250	Telekomi i Kosoves Vala Fikse	5-Jan-21	N/A	Shpenzimet e telefonise fikse, Dhjetor 2020	480.00	Fatura nuk eshte pranuar ne AKP, pritet te pranohet	Administrata Qendrore	AQ5	janar - shkurt 2021	
51	11400	Trusti Pensional	5-Jan-21	MFAKP80239187159	Kontributi i ndalur ne burim ne te ardhurat personale te muajit Dhjetor 2020 per OSH t ne DEP. Likuidimit	1,685.71	Fatura eshte pranuar me 5 janar 21	Likuidimi	L1	janar - shkurt 2021	
52	11400	Trusti Pensional	5-Jan-21	MFAKP8023918772L	Kontributi i ndalur ne burim ne te ardhurat personale te muajit Dhjetor 2020 per Antaret e Bordit te AKPs	2,002.60	Fatura eshte pranuar me 5 janar 21	Administrata Qendrore	AQ1/2	janar - shkurt 2021	
53	11400	Trusti Pensional	5-Jan-21	MFAKP8023918708C	Kontributi i ndalur ne burim ne te ardhurat personale te muajit Dhjetor 2020 per OSH t ne DEP. Administrates	176.19	Fatura eshte pranuar me 5 janar 21	Administrata Qendrore	AQ13	janar - shkurt 2021	
54	11400	Trusti Pensional	5-Jan-21	MFAKP8023918758R	Kontributi i ndalur ne burim ne te ardhurat personale te muajit Dhjetor 2020 per OSH t ne DEP. Riorganizimit	895.25	Fatura eshte pranuar me 5 janar 21	Riorganizimi	RA 1	janar - shkurt 2021	

Gjendja e Faturave të papaguara (shënimi shpjegues nr. 17)
Për periudhën e përfunduar deri më 31 Dhjetor 2020

					Nëntotali	82,715.16				
					Gjithsej detyrimet	82,715.16				
Nr. rendor	Kodi ekonomik	Furnitori	Data e fatures	Numri i fatures	Qellimi	Shuma	Arsyeja e mospageses gjate periudhës raportuese	Vija Buxhetore	Nr. Nenvija buxhetore	Pritet te paguhet ne muajin
		Ndermarrja								
55	11400	Trusti Pensional	5-Jan-21	MFAKP8023918749Q	Kontributi i ndalur ne burim ne te ardhurat personale te muajit Dhjetor 2020 per OSH t ne DEP. Privatizimit	643.68	Fatura eshte pranuar me 5 janar 21	Privatizimi	P6	janar - shkurt 2021
56	14050	XH M Electric	11-Jan-21	002/21	Miremabjtja e Ngrohjeve Qendrore dhe Xheneratoreve	1,110.00	Fatura eshte pranuar me 11 Janar 2021	Administrata Qendrore	AQ 23	janar - shkurt 2021
57	14110	Zenit Invest	2-Dec-21	N/A	Qiraja per ZR ne Gjilan	1,292.00	Fatura eshte pranuar me 7 dhjetor 2020	Administrata Qendrore	AQ25	janar - shkurt 2021
58	13610	Zyra per Publikimin e Gazetes	25-Nov-20	038/2020	Furnizimi me gazeten zyrtare	32.00	Fatura eshte pranuar me 01 dhjetor 2020, fatura eshte rikthet per procesim nga MF ja	Departamenti Ligjor	DL2	janar - shkurt 2021

RAPORTI I AKTIVITETEVE
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2020

PËRMBAJTJA

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
1.1.	TË ARRITURAT KRYESORE.....	4
2.	RREGULLAT DHE PROCEDURAT E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	5
3.	PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	6
3.1.	MISIONI DHE VIZIONI	6
3.1.1	MISIONI.....	6
3.1.2.	VIZIONI.....	6
3.2.	KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT	6
4.	FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA.....	7
4.1.	BORDI I DREJTORËVE	8
5.	DEPARTAMENTI I SHITJES	9
6.	NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT	10
6.1	Ndërmarrjet e Privatizuara me Spin Off Special	10
6.2	Ndërmarrjet e Privatizuara me Kushte	10
6.3	ADMINISTRIMI DIREKT	11
6.4	NDËSHKIMET FINANCIARE	14
6.5	ÇMIM I BLERJES SË AKSIONEVE PËR MOSPËRMBUSHJE TË INVESTIMEVE	14
7	DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT.....	16
7.1.	LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE.....	16
7.2.	NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS (NJTT)	17
8	DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL	18
8.1	SHITJA E ASETVE	18
8.2	ADMINISTRIMI I ASETVE.....	18
8.3	KTHIMI I PRONAVE NË PRONËSI TË NSH-VE.....	19
8.4	IDENTIFIKIMI I ASETVE TE REJA	20
8.5	IDENTIFIKIMI I ASETVE TË MBETURA ME PROBLEME	20
8.6	MENAXHIMI I ASETVE TË MBETURA	20
8.7	QIRADHËNIA E ASETVE TË NSH-ve	21
8.8	PËRCAKTIMI STATUSIT TË NSH-ve	21

8.9	PUNË TJERA	21
9	DEPARTAMENTI LIGJOR	23
9.1	ARBITRAZHET.....	23
9.2	NJËSIA E OPINIONEVE LIGJORE DHE SHQYRTIMIT TË KONTRATAVE TË SHITJES	24
9.3	NJËSIA PËR PËRFAQËSIME LIGJORE	24
9.4	NJËSIA PËR TRAJTIMIN E ASETVE JASHTË VENDIT.....	25
9.5	NJËSIA E SHKRESAVE GJYQËSORE	26
10	DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT.....	27
11	DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	30
12	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	31
13	DEPARTAMENTI I PROKURIMIT.....	32
14	DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE	32
15	NJËSIA E NEGOCIMIT DIREKT	33
16	NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)	35
17	STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	37

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport është paraqitur një përmbledhje e shkurtër e punës së AKP-së për periudhën deri më 31 Dhjetor 2020. Raporti më detajuar për punën e Bordit të Drejtorëve, departamenteve dhe njësive të AKP-së do të paraqiten në raportin vjetor që do të dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa çështjet financiare janë të prezantuar dhe shpalosur në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim dhe Të Hyrat e Dedikuara.

Andaj, jemi fokusuar në pika të shkurtër në këtë raport lidhur me këto fusha:

- Të arriturat kryesore;
- Administrimi dhe Shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve për Ndërmarrjet Shoqërore;
- Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së;
- Përmbledhje lidhur me financat.

1.1. TË ARRITURAT KRYESORE

- Gjatë vitit 2020 kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 36 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete.
- Gjatë vitit 2020 shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm është EUR 5,766,047
- Gjatë vitit 2020 janë shpallur gjithsej 4 lista fillestare për 20% e punëtorëve, 3 lista finale, janë shpërndarë gjithsej EUR 16,501,407 për 74 Ndërmarrje Shoqërore, me përfitues gjithsej 14,132 punëtorë.
- Gjatë vitit 2020 është arritur që në bazë vendimeve të gjykatës të kthej pronat në emër NSH-ve janë arritur të kthehen **2,983,997 m²** në emër të NSh-ve dhe **276.65 m²** lokal poashtu në emër të Nsh-së;
- Janë vënë nën administrim të AKP-së **14 asete** të reja, që më herët nuk i kishim në regjistër të Agjencisë.
- Gjatë këtij viti janë dërguar në përmbardim gjithsej **35** raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt.

Raportet financiare për të hyrat e realizuara nga shitja e aseteve, shpronësimet, qiraja dhe tarifat për pjesëmarrje në tender, për vitin 2020 (si dhe krahasimet me vitet paraprake) janë paraqitur në detaje në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim:

2. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Rregulloret dhe procedurat e aprovuara dhe amandamentimi gjatë vitit 2020 nga agjencia:

1. Amandamentimi i Rregullores së Negocimit Direkt – 29 Janar 2020
2. Ndryshim të periudhës së hulumtimit në shtojcën A të Rregullave të Tenderit dhe për plotësim të Nenit 5.8.2 i Politikave Operacionale – 28 Gusht 2020
3. Amandamentimi/Plotësimi i Udhëzuesit për qiradhënien e aseteve me karakter specifik – 28 Gusht 2020
4. Amandamentimi i Shtojcës 1 të Rregullores së Qirasë - Metodologjia e përcaktimit të çmimit të qirasë – 29 Tetor 2020
5. Akti Themelues i Agjencisë – 27 Nëntor 2020
6. Statuti i Bordit të Drejtorëve – 27 Nëntor 2020
7. Rregullore nr. 1/2020 e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit; – 27 Nëntor 2020
8. Rregullore nr. 2/2020 e punës së Administrimit Direkt; – 27 Nëntor 2020
9. Rregullore nr. 3/2020 për procedurat e parcelimit të aseteve të NSH-ve. – 27 Nëntor 2020
10. Shfuqizimi i disa akteve nënligjore - 22 Dhjetor 2020
11. Shfuqizohen aktet nënligjore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si në vijim:
 - *Rregullore e personelit të AKP-se 28 dhe 29 shtator 2011;*
 - *Rregullore e Personelit 27 qershor 2014 me amand 24 shtator 2018;*
 - *Rregullore për procedurat e rekrutimit të Menaxhmentit 2 shkurt 2016;*
 - *Udhëzues i Prokurimit për Trepçën 29 gusht 2013;*
 - *Rregullorja për monitorim të Trepçës - 21 korrik 2016;*
 - *Rregullore për procedurat e hyrjes dhe daljes 29 gusht 2013;*
 - *Rregullore mbi vlerësimin e performancës së menaxhmentit 29 gusht 2013;*
 - *Rregullore për qasje në dokumente dhe klasifikim të informacionit 14 shkurt 2017;*
 - *Udhëzues për menaxhimin dhe funksionimin e linjës telefonike 13 korrik 2017;*
 - *Strategjia e AKP për informim dhe marrëdhënie me publikun 21 gusht 2017.*
 - *Shfuqizohet kapitulli 7, 8 dhe 9 i Politikave Operacionale të AKP-se 24 tetor 2011, shfuqizohet plotësimi i datës 24 tetor 2011, shfuqizohet plotësimi i datës 7 prill 2016 dhe shfuqizohet pika 2 e plotësimit të datës 21 shtator 2016;*
12. Konsiderohet se këto akte nënligjore janë shfuqizuar me rastin e miratimit të akteve përkatëse pasuese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si në vijim:
 - *Udhëzuesi për Likuidim 28 dhe 29 shtator 2011;*
 - *Udhëzues për shpërndarje të 20% - 30 nëntor 2011;*
 - *Rregullat e procedurës Komisioni për Shqyrtimin e Listave Fillestare 26 gusht 2014.*
13. Rregullorja nr.4/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit - 22 Dhjetor 2020
14. Rregullorja nr.05/2020 për qiradhënien e NSH-ve - 22 Dhjetor 2020
15. Rregullorja nr.06/2020 angazhimit të Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) -22 Dhjetor 2020

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI DHE VIZIONI

3.1.1 MISIONI

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe asete (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe bënë shetjen e tyre, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

3.1.2. VIZIONI

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në Korrik të vitit 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore. Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-Likuidim.

Brenda Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe departamentet dhe njësitë e Veçanta si në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti i Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore;
- Departamenti i Administratës;

- Departamenti i Prokurimit;
- Departamenti i Komisioneve Profesionale; dhe
- Njësia e Negocimit Direkt;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm; dhe
- Njësia e Monitorimit Kontrollës dhe Administrimi Direkt

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA

Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Aktualisht janë **591** Ndërmarrje/njësi punuese të cilat janë nën administrimin e Agjencisë dhe atë:

- **515 janë gjithsej** Ndërmarrje Shoqërore, Trepçës* dhe Ndërmarrjeve të Reja prej; dhe
- **76 janë gjithsej** asete/njësive punuese në Kosovë, ku selitë e NSH-ve janë jashtë Kosovës

* azhurnuar pas miratimit të Statutit të Trepçës nga Kuvendi i Kosovës më 3 Shkurt 2019. NSH Trepça vendoset në likuidim si 1 (një) subjekt juridik, ndërsa numri i njësive biznesore të Trepçës që kanë mbetur nën mandat të AKP-së është 9 (nëntë).

Këto 591 ndërmarrje kanë statusin e mëposhtëm:

Numri i Ndërmarrjeve/aseteve aktualisht nën administrimin e Agjencisë	591
Vendosur në likuidim	579
Numri i NSH-ve në likuidim të përmbyllura me vendim të Dhomës së Posaçme	(32)
Ende në proces të likuidimit	547
Kosovatransat dhe Ekonomitë Pyjore që nuk do të vendosen në likuidim	11
Nuk janë vendosur ende në likuidim*	14

* Në dhjetor të vitit 2020 është marrë vendimi për fillimin e likuidimit për 12 NSH/Asete tjera, për të cilat fillimi i likuidimit do të jetë data 18 janar 2021.

4.1. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej¹ funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i Bordit të Drejtorëve është katër vjeçar për të gjithë anëtarët e Bordit. Kuvendi me datë 07 Mars 2019 ka emëruar Kryesuesin e Bordit dhe një anëtar tjetër të Bordit.

Gjatë vitit 2020, deri në fund të këtij viti, Bordi ka mbajtur 17 mbledhje, ku janë marrë gjithsej 539 vendime formale dhe shumë udhëzime për veprim për Menaxhmentin. Në vijim, në mënyrë përmbledhëse janë të paraqitura aktivitetet e Bordit për këtë periudhë:

1. Janë aprovuar shitjet nga valë të shitjeve të aseteve në likuidim (SHAL54, SHAL 55 (pas shpalljes kjo valë është pezulluar duke u bazuar në vendimin e Qeverisë për pezullim të aktivitetit të Agjencisë);
2. Janë bërë shpërndarjet në likuidim për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
3. Janë aprovuar raporte Rekomanduese dhe Perfundimtare të Njesise për Negocim Direkt;
4. Janë bërë shpërndarjet për ish-punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore nga 20% i shitjeve;
5. Janë aprovuar raporte të Komisionit për Shitjen e Banesave në Pronësi Shoqërore;
6. Janë aprovuar qiradhënie të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
7. Është aprovuar fillimi i likuidimit për 21 ndërmarrje;
8. Janë aprovuar raporte për përcaktimin e statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore;
9. Gjatë vitit 2020 gjithsej 71,496,816.32 euro janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (53,739.44 € fonde të mbetura dhe 71,443,076.88 € fonde të përkohshme);
10. Është aprovuar plani i punës për vitin 2020 dhe buxheti për vitin 2021 si dhe raporte tjera që u përcillen institucioneve qendrore sipas ligjit në fuqi;
11. Duke parasysh masat e Qeverisë lidhur me pandeminë virusi Covid-19 është aprovuar zgjatja e afatit të pagesave të cilat janë në proces për shitjen e aseteve me tender dhe shitjen me negociim direkt si dhe pagesave për qira të aseteve të NSH-ve dhe shtyrje e afateve për lista të punëtorëve.
12. Janë aprovuar dhe/ose amandamentuar akte nënligjore të Agjencisë. Rregulloret e reja janë në shënimin shpjegues nr. 2
13. Duke parasysh masat e Qeverisë lidhur me pandeminë virusi Covid-19 është aprovuar zgjatja e afatit të pagesave të cilat janë në proces për shitjen e aseteve me tender dhe shitjen me negociim direkt si dhe pagesave për qira të aseteve të NSH-ve dhe shtyrje e afateve për lista të punëtorëve të aprovuar, "Marrëveshja e Mirëkuptimit" me Komunën e Skenderajt për pagesën e shpronësimit respektivisht të shumës prej EUR 75,619.88 që është 20% për punëtorët e NSH-së me 4 kështe brenda viteve 2020.
14. Është aprovuar lejimi/pëlqimi për pronën e NSH IGK Ballkan për zhvillimin e projektit të komunës së Suharekës për zhvillimin e projektit kapital në interes të përgjithshëm me zotimin e kësaj Komune që në momentin e vlerësimit të pronave ata do të paguajnë vlerën sipas nenit 6A, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit të AKP-së.

¹ Përbërja, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve janë të paraqitura në nenet 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (të ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 04/L-115).

5. DEPARTAMENTI I SHITJES

Një ndër objektivat kryesore të AKP-së është rritja dhe ruajtja e vlerës të aseteve të NSh-ve dhe se AKP-ja përpaket të ruaj raportin e realizmit të shitjeve me vlerën e synuar. Pra strategjia është sfiduese e cila kërkon ruajtjen e këtij bilanci dhe e cila kryesisht varet nga faktorët e jashtëm dhe situatat e mëposhtëm:

- **Fuqia blerëse** – absorbimin e ofertave kundrejt vëllimit të shitjeve;
- **Menaxhimin efikas dhe efektiv të aseteve** – p.sh. afatet kohore të marrëveshjeve të qirave dhe vënia në dispozicion për shitje tek blerësit;
- Koordinim me institucionet relevante të tilla si: objektet e shfrytëzuara nga institucionet, ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, komunat, bashkëpunimi me ATK-në rreth barrës tatimore etj.;
- Lirimin e aseteve nga uzurpatorët;
- Trajtimin e ndërtimeve ilegale të aseteve të NSh-ve; dhe
- Kompletimin e dokumentacionit (regjistrave kadastral).

Gjatë vitit 2020 nuk është arritur të mbahen shitjet e aseteve ashtu siç janë planifikuar.

Me vendimin e pranuar nga Qeveria e Kosovës me datë 23 mars 2020 AKP-së i është ndaluar të vazhdohet me shitjet e aseteve përmes likuidimit .

Pra gjatë vitit 2020 është mbajtur vetëm një shitje e aseteve.

Shitje e vetme e realizuar për 2020 është mbajtur më 21 Janar 2020. Në vijim janë rezultatet për këtë shitje.

Shitja përmes Likuidimit	Nr. i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave Fituese	Tërheqjet, Anulimet	Gjithsej Vlera	Nr. i Aseteve të anuluar nga BiD, tërheqjet	Kontratat e realizuara	Shitjet e parealizuara – në proces
54	93	91	2,254,338	386,808	1,867,530	13	25	25

6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT

Raport i Njesisë për Monitorim, Kontroll dhe Administrim Direkt për periudhën nga 01.01.2020 deri 31.12.2020:

NJMKAD merret me administrimin me ndërmarrjet të cilat kanë vështirësi financiare dhe biznesore prandaj me qëllim të rritjes së kontrollit dhe efikasitetit të këto ndërmarrje Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka vendosur për futjen e këtyre ndërmarrjeve në Administrim Direkt. Njësia për Monitorim, kontroll dhe Administrim Direkt gjithashtu ka për detyrë që për ndërmarrjet që nuk janë liruar nga marrëveshja e zotimeve të monitorojë dhe raportoj për gjendjen në këto ndërmarrje.

Përpos kësaj nga ndërmarrjet që janë ende aktive dhe nuk janë futur në likuidim, NJMKAD nga zyrat regjionale pranon raportet financiare.

6.1 Ndërmarrjet e Privatizuara me Spin Off Special

Ndërmarrja e Re "Agrokosova Holding" Suharekë

Ndërmarrja e Re "AgroKosova Holding" ende është në monitorim nga AKP –ja dhe bazuar në të gjitha raportet e auditimit për periudhën nga privatizimi 27 gusht 2007 deri me 5 prill 2017 kur është aprovuar zgjatja e marrëveshjes së zotimeve nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së vlera e përgjithshme e investimeve bazuar në raportet e auditimit është si në vijim:

Përshkrimi	Zotimi	Vlera/numri	%
Përmbushja e zotimeve për investime kapitale	8,600,000.00	7,378,005.82	85.79%
Përmbushja e zotimeve për punësim	3075	759	24.67%

Për shkak të mos përmbushjes së marrëveshjes së zotimeve Blerësit iu janë lëshuar ndëshkime financiare por në të cilat ai është ankuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe pasi që ende janë duke u zhvilluar disa seanca gjyqësore nuk ka ndonjë vendim final lidhur me këtë ndërmarrje.

6.2 Ndërmarrjet e Privatizuara me Kushte

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Pejë

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" sh.p.k., është privatizuar si projekt individual ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 qershor 2013 dhe periudha e zotimeve ka qenë deri më 14 qershor 2016. Agjencia Kosovare e Privatizimit ende nuk ka shqyrtuar raportin për përmbushjen e zotimeve nga ana e blerësit për shkak të mos qartësisë të një parcele kadastrale ku AKP edhe përkundër marrjes së një numri të madh veprimesh nuk ka arritur të konstatojë qartë se parcela në fjalë ka qenë si aset i përfshirë në privatizim me rastin e shitjes së Ndërmarrjes së Re. Gjithashtu Menaxhmenti i AKP-së ka dërguar shkresë dhe ka kërkuar nga organet kompetente që të shqyrtojnë dhe hetojnë këtë situatë lidhur me këtë parcelë kadastrale. Ende nuk kemi pranuar ndonjë informatë mbi këtë rast.

Ndërmarrja e Re “Kualiteti International” Gjilan

Gjatë vitit 2020 nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet vetëm se gjatë kësaj periudhe është pranuar vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme lidhur me ankesën AKP-së mbi ndërtimet që janë bërë nga ana e Blerësit pa lirim formal nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së për këtë ndërmarrje dhe ku sipas këtij vendimi Blerësi pas përfundimit të periudhës monitoruese nuk ka ndonjë obligim ndaj AKP-së.

6.3 ADMINISTRIMI DIREKT

Ndërmarrja e Re “MIM Golesh” Magure

Ndërmarrja e Re “MIM Golesh” aktualisht nuk është duke inkasuar të hyra nga aktiviteti i saj primar por shitja e materialeve të cilat janë të deponuara si stok nga kontrata paraprake që ka pasur me “Bechtel Enka” dhe ku bazuar në vështirësitë financiare të Ndërmarrjes Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka marrë vendim për shitjen e disa materialeve të mbetura të Ndërmarrja.

Pas dështimit të tenderit me operatorin ekonomik “Dino” sh.p.k. materialet e dunitit janë ri-tenderuar prapë dhe në procedurën e tenderimit, fitues i tenderit është shpallur Operatori Ekonomik “ED Berisha” sh.p.k. nga Malisheva. Vlera e kontratës me “ED Berisha” sh.p.k. për shijen e materialit të dunitit është në vlerë prej 100,540.00euro me TVSH plus 64,000 euro nga materiali shtesë që është kërkuar të blihet nga “ED-Berisha” sh.p.k. edhe e cila është e aprovuar në Bord. Ndërmarrja aktualisht të vetme të hyra është duke i realizuar nga shitje a materialit të dunitit tek OE “ED Berisha” sh.p.k.

Me qëllim të rritjes së të hyrave AKP/NJMKAD me datë 11 shtator 2020 ka shpallur në të përditshmen informative shitjen e materialit të dunitit në sasi prej 350,000m³ në masë kompakte por i cili tender ka dështuar, të njëjtën sasi e kemi ri-tenderuar por për shkak të çmimit të ulët të ofruar anëtarët e komisionit unanimisht kanë anuluar tenderin në fjalë dhe kanë rekomanduar që i njëjti të ri-tenderohet për arsye se çmimi i ofruar prej 1.19€/m³ nuk është në përputhje me çmimin e tregut dhe është i nënvlerësuar.

Ndërmarrja me datë 02.11.2020 është pajisur me licence të nga KPMM për shfrytëzimin e dunitëve në sipërfaqe prej 23780.63m² me nr. 2163/KPMM/2020. Licenca me nr. 2163/KPMM/2020 është për nëntë (9) vite dhe Ndërmarrja ka siguruar garancionin e ri bankar në NLB Bank në vlerën totale prej 12,540.00euro (11,900.00euro në emër të garancionit dhe 550.00euro për shërbime administrative për nëntë vite).

Në muajin dhjetor 2020 në Ndërmarrjen e Re “MIM Golesh” kanë qenë të angazhuar 42 punëtor ku numri më i madh i punëtorëve është i angazhuar në ruajtjen e aseteve duke konsideruar faktin se hapësira e Ndërmarrjes është shumë e madhe 267 ha, ndërsa punëtorët tjerë janë të angazhuar në menaxhim dhe mirëmbajtje të aseteve të cilat janë shumë të rëndësishme për Ndërmarrjen, si dhe në administratë, kontabilitet etj.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, me datë 22 dhjetor 2020 ka marrë Vendim për largimin e NR “MIM Golesh” nga Administrimi i Drejtpërdrejtë i AKP-se, dhe Ndërmarrja prej datës 18 janar 2021 të vendoset në Likuidim.

NSH “Boksitet e Kosovës” Klinë

Të hyrat e vetme të Ndërmarrjes sigurohen nga lëshimi i aseteve të Ndërmarrjes me qira.

Gjendja financiare në Ndërmarrje është mjaftë e vështirë dhe të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka katër asete të dhëna me qira – Zyra e Drejtorisë në Klinë, Autoparkingu në Klinë, Fabrikën e Llaçit të Thate në Volljak dhe Seperacionin në Volljakë.

Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 7,828.00 Euro, kurse në ndërmarrje janë të punësuar shtatëmbëdhjetë (17) punëtor prej të cilëve dy (2) paguhen nga subvencionet, tre (3) janë ofrues të shërbimeve dhe dymbëdhjetë (12) punëtor paguhen nga të hyrat e Ndërmarrjes.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, me date 22 dhjetor 2020 ka marrë Vendim për largimin e N.SH. “Boksitet e Kosovës” nga Administrimi i Drejtpërdrejtë i AKP-se, dhe Ndërmarrja prej datës 18 janar 2021 të vendoset në Likuidim.

NSH “Ereniku Industria” Gjakovë

Të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka katër asete të dhëna me qira. Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 1,368.00 euro.

Në Ndërmarrje janë të punësuar katër (5) punëtor prej të cilëve katër (4) punëtorë paguhen prej të hyrave të Ndërmarrjes dhe një (1) punëtorë paguhen prej subvencioneve. Gjithashtu në ndërmarrje janë të angazhuar pesë (5) punëtor si ofrues të shërbimeve të cilët merren me ruajtjen e aseteve të ndërmarrjes dhe një ofrues i shërbimeve i cili është i angazhuar si Arkivist.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, me date 22 dhjetor 2020 ka marrë Vendim për largimin e N.SH. “Ereniku-Industria” nga Administrimi i Drejtpërdrejtë i AKP-se, dhe Ndërmarrja prej datës 18 janar 2021 të vendoset në Likuidim.

NSH “Virginia” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Ndërmarrja nuk e zhvillon aktivitetin e saj primar por të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira.

Aktualisht Ndërmarrja ka nëntëmbëdhjetë (19) kontrata të qirasë dhe të hyrat mujore janë afër 3,345.61 Euro. Në ndërmarrje janë të punësuar 19 punëtorë prej të cilëve tre janë në Bordin e Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes. Pagat bruto për muaj të cilat paguhen nga ndërmarrja janë 2.600.00 Euro.

Gjatë vitit 2020 është realizuar edhe shitje e disa mbetjeve metalike përmes tenderit publik dhe tenderimi i disa objekteve/lokaleve për qiradhënie, konformë Udhëzuesit për dhënien e aseteve të NSH-ve me qira.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, me date 22 dhjetor 2020 ka marrë Vendim për largimin e N.SH. “Virxhinia” nga Administrimi i Drejtpërdrejtë i AKP-se, dhe Ndërmarrja prej datës 18 janar 2021 të vendoset në Likuidim.

NSH “Jatex” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt.

Aktualisht ndërmarrja nuk është duke operuar me aktivitetin e saj primar, për shkak të gjendjes së vështirë financiare. Të vetme të hyra Ndërmarrja i realizon nga dhënia e aseteve me qira.

Aktualisht Ndërmarrja ka 36 kontrata të qirasë dhe të hyrat neto mujore nga qiraja janë në vlerë prej 21,084.00 euro.

Gjate vitit 2020 janë tenderuar mbetjet metalike/hekurishtet dhe janë tenderuar objektet/lokalet për qiradhënie konformë Udhëzuesit për dhënien me qira të aseteve të NSH-ve. NSH “Jatex” nga shitja e mbetjeve metalike/hekurishteve deri më 31.12.2020 ka realizuar të hyra në vlerë prej 57,629 Euro.

Numri i punëtorëve në Ndërmarrje është dyzet e një (41), të cilët paguhën nga të hyrat të cilat Ndërmarrja i realizon nga dhënia e aseteve me qira ose shitja e hekurishteve.

NSH “Metaliku” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Gjendja në këtë ndërmarrje është mjaftë e vështirë dhe pjesa dërmuese e aseteve janë të dëmtuara dhe kryesisht kemi objektet të cilat janë pa makineri dhe jo funksionale.

Pasi që deri në futjen e ndërmarrjes në Administrim Direkt, Ndërmarrja nuk ka pasur asnjë të hyrë të realizuar nga qiraja apo ndonjë aktivitet tjetër, AKP me kërkesë të Bordit të Përkohshëm Menaxhues dhe me qëllim të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes gjatë vitit 2020 ka lëshuar disa objekte me qira ku vlera mujore e qirave ka qenë afër 4,000.00 Euro. Në ndërmarrje janë të angazhuar 6 punëtor prej të cilëve dy janë në Bord të Përkohshëm Menaxhues dhe 4 në ruajtjen e objekteve të ndërmarrjes.

NSH “Fabrika e Enëve” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Ndërmarrja deri në futjen në Administrim Direkt nuk ka realizuar asnjë të hyrë dhe nuk ka pasur asnjë të punësuar.

Pas futjes së ndërmarrjes në Administrim Direkt së bashku me Bordin e Përkohshëm Menaxhues janë identifikuar asetet që mund të jepen me qira dhe është bërë shpallja publike ku vlera mujore e të hyrave nga qiratë ka qenë afër 540.00 Euro. Nga Nëntori i vitit 2020 e tere hapësira e ndërmarrjes iu është lëshuar me qira Operatorit Ekonomik “Viva Fresh” në vlerë mujore prej 17,165.80 Euro. Në ndërmarrje janë të punësuar tre ofrues të shërbimeve si roje dhe tre anëtar të Bordit Menaxhues.

NSH “Iliria” Pejë

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30/31 mars 2017 ka marrë Vendim për vendosjen e NSH “Iliria” në Administrim Direkt të AKP-së.

Me datë 21 Shtator 2018 kemi pranuar përgjigje nga KK Pejës-Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër se pronat NSH “Iliria”, ish “Izgradnja” janë bartur në emër të SH. A. “Izgradnja” sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme e Kosovës ARJ-UZVP.nr.31/2017 të dt. 10.05.2018.

Zyra Ligjore e AKP-së ka ushtruar padi për vërtetim pronësie kundër të ashtuquajturës Sh.A. "Izgradnja" Pejë.

AKP deri në marrjen e vendimit nga Gjykata është duke administruar vetëm me pronën në Obiliq e cila është në emër të NSH "Iliria" ish Izgradnja dhe te cilën e ka dhënë me qira mujore prej 100.00 Euro.

Gjatë vitit 2020 me Vendim të DM të AKP-se, është themeluar komisioni i cili ka pas për detyrë vlerësimin dhe hulumtimin e çmimit të tregut për pronën e Ndërmarrjes në Obiliq.

Anëtarët e komisionit kanë vlerësuar pronën e Ndërmarrjes në Obiliq me konkretisht ngastrën kadastrale 1375/2 në sipërfaqe prej 376m² dhe një pjese të ngastrës kadastrale 1375/4 në sipërfaqe prej 543m², në total sipërfaqja e dhënë me qira është 919m².

Gjithashtu, komisioni vlerësues ka kërkuar nga qiramarrësi që të paguan në mënyrë retroaktive edhe për tri vitet e fundit për shkak se e ka shfrytëzuar pronën e Ndërmarrjes, përveç qirasë mujore.

6.4 NDËSHKIMET FINANCIARE

Gjatë vitit 2020 nuk janë aplikuar ndëshkime financiare por janë duke u zhvilluar proceduar përmbartimore nga Departamenti Ligjor për të shikuar mundësinë e inkasimit të tyre.

Më poshtë paraqesim tabelën e ndëshkimeve financiare

Ndërmarrja	Vlera e ndëshkimeve
Ndërmarrja e Re "Grand Hotel"	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re "Xim Strezoc"	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re "Agrokosova Holding"	3,579,997.53
Ndërmarrja e Re "Llamkos"	1,715,488.79
Ndërmarrja e Re "Famipa"	1,170,000.00
Totali i ndëshkimeve financiare	31,033,784.32

Bordi i Drejtorëve ka vendosur që për ndërmarrjet "AgroKosova Holding" dhe "Llamkos Galvasteel" të pritët vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm, kurse për ndërmarrjet që iu janë marrë aksionet "Grand Hotel" Prishtinë ; "Mim" Golesh dhe "Xim" Strezoc si dhe për ndërmarrjen "Famipa" nga Departamenti ligjor janë duktë ndërmerren hapat për inkasimin e tyre.

6.5 ÇMIM I BLERJES SË AKSIONEVE PËR MOSPËRMBUSHJE TË INVESTIMEVE

Për Ndërmarrjen e Re "Sharrcem" Hani i Elezit, vlera e mos përmbushjes së zotimeve për investime kapitale prej 9,441,768.83 bazuar në raportin e auditorit të pavarur është llogaritur si çmim i blerjes bazuar në kontratën e shit blerjes.

Ndërmarrja	Vlera
------------	-------

Ndërmarrja e Re “Sharrcem” Hani i Elezit	9,441,768.83
--	--------------

Për Ndërmarrjen e Re “Sharrcem” Hani i Elezit rasti është në arbitrazh pasi që Blerësi nuk është pajtuar me vlerën e ndëshkimeve të aplikuara.

Gjithashtu janë pjesë e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim tek llogaritë e arkëtueshme “shitja e aseteve”.

7 DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT

7.1. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2020 kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 36 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete. Sipas procedurave të parapara me Ligj, janë bërë publikimet e njoftimeve për kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjeve në dy gazeta serbe, një në Serbi dhe një në Mal të Zi ndërsa në Kosovë publikimet janë bërë në portale sepse si rezultat i pandemisë globale Covid 19, gazetat nuk janë shtypur prej muajit mars 2020. Brenda afatit të paraparë ligjor për parashtrimin e kërkesave për këto ndërmarrje deri më 31 Dhjetor 2020 janë pranuar 279 kërkesa kreditore në Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së.

Në total, nga fillimi i tërë procesit deri në datën e raportimit janë gjithsej 567 Ndërmarrje Shoqërore për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit. Këto Ndërmarrje Shoqërore në likuidim janë administruar nga Autoritetet e Likuidimit (OSHP me AKP-në) për NSH-të të cilat kanë asete sipas shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale.

Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar implementimi i kontratës ndërmjet AKP-së dhe OSHP-së (Curtis, Mallet-Prevost, Colt&Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC), e cila ka filluar me 1 korrik 2019.

Në muajin qershor 2019 ndërmjet AKP-së dhe OSHP-së (Curtis, Mallet-Prevost, Colt&Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC) është nënshkruar kontrata për likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore/aseteve nën administrimin e AKP-së, e njëjta ka filluar me datë 1 korrik 2019 me kohëzgjatje deri me 30 qershor 2024. Si rezultat i nënshkrimit të kontratës së lartpërmenduar janë emëruar Autoritetet e Likuidimit nga personeli i OSHP-së dhe AKP-së, për të gjitha NSH-të në likuidim dhe që janë nën kompetencën e OSHP-së.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar pagesa në vlerë 480,868.16 euro për OSHP-në.

PËRSHKRIMI	JANAR-DHJETOR 2020	TËRË PROCESI 31 dhjetor 2020
Numri i NSH-ve në likuidim	36	567
Numri i kërkesave të parashtruara të kreditorëve	279	91,620
Numri i kërkesave të shqyrtuara	132	91,232
Numri i NSH-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK)	0	32
Numri i raporteve të shpërndarjes së përkohshme, të shpërndarjes përfundimtare apo raporte përfundimtare të aprovuara nga Bordi	31	207
Shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm	5,766,047	34,831,275

Nga numri prej 91,620 të kërkesave kreditore, deri në datën e raportimit për 91,232 janë lëshuar vendimet për parashtruesit e kërkesave kreditore nga Autoritetet e Likuidimit.

7.2. NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS (NJTT)

Vendimi i Moratoriumit për njësitë e Trepçës që është ende në fuqi, nuk ka lejuar marrjen e masave, për likuidim apo tjetërsimin e pronës, pa informim e miratim paraprak nga Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme. Kjo ka bërë që në vitin 2020 të mos iniciohen punët transitore të njësive jothelbësore të Trepçës, të cilat kanë ngelur jashtë përbërjes së Trepça ShA, dhe janë nën administrim të AKP.

Gjatë 2020, Njësia e Trepçës pas identifikimit të listës preliminare së pronave të Trepçës jashtë vendit (jashtë RKS), është drejtuar tek Ministria e Ekonomisë, dhe vetë Trepça ShA, për të kërkuar informata rreth çdo dokumentacioni eventual, që mund të ndihmojë dëshminë për pronësi të aseteve të Trepçës jashtë RKS, si dhe, ka kërkuar dokumente mbështetëse të pronësisë edhe në arkivin qendror të RKS.

NjTT gjatë 2020 ka asistuar Departamentin Ligjor në përfaqësimin gjyqësor për rastet e njësive të Trepçës që administrohen nga AKP, bazuar në Ligjin e Trepçës dhe Statutin e Trepça ShA.

NjTT ka administruar kërkesat e Njësive joesenciale të Trepçës. Kërkesat e tilla si në rastin e Fabrikës së Municionit të Gjuetisë në Skenderaj, që nuk ka të hyra, dhe nuk mund të paguajnë komunalet, janë administruar nga NjTT, dhe mbuluar nga Agjencia.

Gjatë vitit 2020, NjTT është përgjigjur edhe në kërkesat për informata nga parashtruesit e kërkesave kreditore të afateve ligjore të kaluara në rastin e Trepçës, si dhe ka plotësuar dhe përditësuar dokumentacionin për procesin e që pritet të ndodh së shpejti, respektivisht - shpallja e likuidimit.

Viti 2020 që ishte i varfër lidhur me aktivitetet rreth njësive joesenciale të Trepçës, ishte edhe vit kur u anuluan vizitat e parapara për financim në finalizim të Projektit të parafizibilitetit të MIM Goleshit, proces ky me të cilin është marr NjTT gjatë 2019, dhe për të cilin gjatë fundvitit 2019 dhe fillimvitit 2020, kishte interesim nga investitorë. Por, ky interes është ndalur për shkak të rrethanave të Covid19.

8 DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bën mbikëqyrjen dhe Koordinimin e punës së Zyrave Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicë që përfshijnë të gjithë territorin e Kosovës dhe zyrën satelitore në Shtërpçë, të cilat përgjegjësi kryesore kanë grumbullimin e informative lidhur me NSh-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

8.1 SHITJA E ASETEVE

Zyrat Rajonale kanë përgatitur për shitje te aseteve në Likuidim me që rast janë përfshirë **357 asete** për shitje gjatë këtij viti të shpërndara në **3 Valë të shitjes përmes Likuidimit**, mirëpo për shkak të situatës së krijuar me pandemi globale vetëm një shitje (SHAL54) është realizuar e cila ka përmbajtur gjithësej 93 asete.

Zyrat Rajonale kanë përgatitur për shitje përmes Likuidimit numrin e aseteve siç është paraqitë në tabelën e shitjeve të shpalosur te Departamenti i Shitjes.

Përgatitja e shitjeve nënkupton edhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve përcjellëse të cilat kalojnë nëpër shqyrtim kadastral dhe ligjor, duke filluar nga:

- Raporti i Vizitave në Teren
- Memorandumet e Informimit për Bord
- Të Dhënat për Ndërmarrjen në Likuidim,
- Përshkrimet e Shkurta,
- Memorandumet e Informimit,
- Dokumente të Caktuara Ligjore dhe Rreziqet Tjera si dhe
- Bazën e të Dhënave për propozimet e mundshme të investimeve.

Gjatë vitit 2020, zyret rajonale kanë dorëzuar **100** kontrata të shitjeve përmes likuidimit tek blerësit.

8.2 ADMINISTRIMI I ASETEVE

Agjencia sipas mandatit të saj, nga viti 2002 deri më 31 dhjetor 2020 ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej **4,638** asete të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ky numër paraqet numrin e të gjitha aseteve të shitura dhe të pashitura të cilat janë identifikuar nga ana e Agjencisë brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës. Më poshtë janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare të aseteve sipas territorit apo llojit të tyre nga viti deri më 31 dhjetor 2020.

Asetet e mbetura (të pashitura) me të cilat ende administron AKP-ja janë gjithsej **2,329** ndërsa asetet jashtë Kosovës janë **163 asete** të Ndërmarrjeve Shoqërore pa e përfshirë asetet e Trepçës. Gjithsesi, ky numër mund të ndryshoj në periudhat pasuese, varësisht në ndërrimin e statuseve të NSh-ve apo identifikimit të aseteve të NSh-ve përkatëse

RAPORTI PËRMBLEDHËS I ASETVE TË PASHITURA BREND KOSOVËS**Tabela 1 - Numri i aseteve të pashitura sipas kategorisë dhe rajonit**

	1	2	3	4=sum(1:3)	=4/total
Rajoni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej	%
Prishtina	239	226	61	526	23%
Peja	211	269	137	617	26%
Prizren	124	402	15	541	23%
Gjilan	44	169	28	241	10%
Mitrovica	199	176	29	404	17%
Gjithsej	817	1242	270	2329	100%

Tabela 2 - Numri i aseteve të pashitura jashtë Kosovës**Asetet jashtë Republikës së Kosovës:**

Shteti	Numri i aseteve	%
Bosna dhe Hercegovina	15	9%
Kroaci	5	3%
Mali i Zi	35	21%
Maqedoni	8	5%
Serbi	99	61%
Slloveni	1	1%
GJITHSEJ	163	

Gjatë kësaj periudhe lidhur me këto asete, AKP-ja kryesisht ka administruar lidhur me: përgatitjen e aseteve për shitje, administrimin e qirave, në koordinim me institucionet – shpalljen e interesit publik, kontestet gjyqësore dhe të tjera.

8.3 KTHIMI I PRONAVE NË PRONËSI TË NSH-VE

Gjatë vitit 2020 është arritur që në bazë vendimeve të gjykatës të kthej pronat në emër NSH-ve janë arritur të kthehen **2,983,997 m²** në emër të NSH-ve dhe **276.65 m²** lokal poashtu në emër të Nsh-së;

- NSH Ratar ngastrat nr. 1397/1 dhe 2 me sipërfaqe **39,830 m²**, ZK Cagllavice;
- NSH "Nishpromet" – lokal afarist me sipërfaqe prej **276.65 m²**, ne Dardani, Prishtine.
- C.nr. 587/15- PRZ009 DLB – ngastra nr. 683-0 ZK Lubizhde **-11,348 m²**;
- C.nr. 693/15, /PRZ009 DLB - ngastra 158-6 ZK Dushanove- **1,988 m²**;
- C.nr. 248/16 / PRZ009 - ngastra 187-7, ZK Dushanove, **-1,300 m²**;
- C.nr. 250/16 /PRZ009DLB - ngastra 158-9, **1,000 m²**;
- C.nr. 685/15 / PRZ009 - ngastra 158-8 ZK Dushanove- **3,000 m²**;

- Vendimin e Gjyktës së Apelit për anulim dhe shqyrtim të vendimit të KK Pejë për bartje të pronës, në bazë të vendimeve të KK Pejë sipërfaqja e pronës së bartur në emër të KK Pejë është 3,013,892 m².

8.4 IDENTIFIKIMI I ASETEVE TE REJA

Vetëm këtë vit kemi identifikuar dhe kemi vënë nën administrim të AKP-së **14 asete** të reja, që më herët nuk i kishim në regjistër të Agjencisë.

8.5 IDENTIFIKIMI I ASETEVE TË MBETURA ME PROBLEME

Gjatë këtij viti në sistemin e menaxhimit të aseteve ku janë të identifikuar asetet e mbetura, për secilin aset është bërë identifikimi i problemeve dhe përmbledhja është paraqitur si në vijim:

Rajoni	Prishtina	Peja	Prizren	Gjilan	Mitrovica	Gjithsej	
Vendim te Qeverise	12	50	8	39	66	175	7.9%
Mase te Perkoshme	39	31	-	11	3	84	3.8%
Opinioni I DHPGJS	3	1	2	5	5	16	0.7%
Munges e dokumentacionit	2	8	18	29	30	87	3.9%
Tranzicion	54	21	55	-	8	138	6.2%
Parcelim	4	74	155	74	39	346	15.6%
KNI	54	93	29	46	38	260	11.7%
Problem Pronsor/Kadastral	182	183	-	62	201	628	28.3%
Heqje Dore	31	66	41	39	20	197	8.9%
Komesacion	3	33	1	5	31	73	3.3%
Kulture mal	-	64	-	19	9	92	4.1%
Trashegimi Kulturore	1	-	41	1	1	44	2.0%
Leshimi I certifikatave (bashkë. komunat)	-	-	1	16	64	81	3.6%
GJITHSEJ	385	624	351	346	515	2,221	100%

8.6 MENAXHIMI I ASETEVE TË MBETURA

Edhe gjatë kësaj periudhe pjesë thelbësore e strategjisë ka qenë edhe menaxhimi i aseteve.

AKP-ja menaxhon me një numër të madhë të aseteve apo të NSh-ve që janë të mëdha dhe komplekse të tilla si NSh Grand Hotel, NSh ABC Genci dhe NSh Tregu.

Përveç menaxhimit me NSh-të e mëdha dhe komplekse, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike si dhe atë pandemike dhe sistemin gjyqësor në Kosovë, implementimi i politikave në dhënien me qira të aseteve për AKP-në ka qenë sfidë në vete.

Pas një analize të detajuar të vendimeve të Qeverisë për ndalimin e veprimtarisë/aktiviteteve të bizneseve në lidhje me qiramarrësit e pronave shoqërore, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 25 qershorit 2020 morri vendim duke autorizuar Menaxhmentin dhe Autoritetin e likuidimit të lejojë lirin nga detyrimet e papaguara në vlerë 100% të qirave për periudhën për të cilën kanë pasur të ndaluar aktivitetet sipas vendimeve të publikuara të Qeverisë, si dhe faljen e detyrimeve të papaguara të qirasë në vlerë 70% të qirasë për ato biznese (qiramarrëse të aseteve të Nsh-ve), që kanë pasur të lejuar, mirëpo të cilat për arsye të shtjelluar më lartë kanë operuar me kufizime/pjesërisht mirëpo me një rënie të madhe të qarkullimit si pasojë e kufizimeve dhe rënies së fuqisë blerëse. Shuma e lirit nga detyrimet arrin vlerën rreth **570,000 euro**.

Gjithsesi, marrë parasysh këta faktor, AKP-ja ka inkasuar qira në nivel të kënaqshëm prej **EUR 3,204,604** dhe atë:

- Qiraja e inkasuar për NSh-të në likuidim prej **EUR 2,524,978**
- Qiraja e inkasuar për NSh-të në tranzicion prej **EUR 679,662**.

8.7 QIRADHËNIA E ASETEVE TË NSH-VE

Gjithashtu gjatë vitit 2020, zyret rajonale kanë përgatit dhe kanë marrë aprovim nga kryesuesit e AL-ve dhe Menaxhmentit, dhe Bordi i Drejtorëve për qiradhënie të pronave të NSH-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënies, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie për **25 asete në total** prej tyre më 10 shkurt 2020 ku janë përfshirë gjithsej 8 asete në likuidim dhe 4 asete në tranzicion, më 19 qershor 2020 ku janë përfshi 13 asete në likuidim.

Gjatë këtij viti janë dërguar në përmbardim gjithsej **35** raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt.

8.8 PËRCAKTIMI STATUSIT TË NSH-VE

Gjatë këtij viti janë procesuar një (1) Kërkesa për Përcaktimin e Statusit (SDR) për Asetet e NSH-ve me seli jashtë Kosovës për të cilat është siguruar dokumentacion, për shqyrtim nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Përcaktimin e Statusit të NSH-ve.

8.9 PUNË TJERA

- Janë identifikuar të gjitha asetet sipas vendimit të Qeverisë për kthim të pronave dhe pronësi të Komunave që gjithsej përfshin **763** asete, prej tyre nga Qeveria janë pezulluar **31** asete.
- Është azhurnuar lista me Vendime të Shpronësimeve që përfshin gjithsej janë **1,351** asete, prej tyre janë **746** asete të ndërmarrjeve shoqërore dhe **605** asete të Ekonomive Pyjore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht **5,000 hektar** dhe ky numër pritet të rritet pasi që po vazhdohet të merren vendime për shpronësim na baza të rregullta.
- Gjatë këtij viti janë përgatitur BB për **48 NSh** ku prej tyre **36 NSh** gjatë vitit kanë filluar procedurat e likuidimit kurse për **12 NSh** procesi i likuidimit fillon me 18 janar 2021.

Sfidat

- Mungesa e dokumentacionit të pronësisë si dhe të dhënat e vjetruara kadastrale të pronësisë në raste kur NSh-ja posedon të dhëna të gabuara sa i përket pronësisë të aseteve të caktuara. Zyrtat Komunale Kadastrale në shumë raste nuk janë shumë bashkëpunuese dhe vazhdimisht refuzojnë të azhurnojnë të dhënat kadastrale.
- Parcelimi i tokave në rastet ku përmes pronës kalon rrugë, varreza, ndërtime të shtëpive etj. paraqet pengesë në përgatitjen e këtyre pronave për shitje me që rast janë identifikuar rreth **300 asete** të cilat kanë nevojë për parcelim.
- Mosplotësimi i pozitave të lira të zyrtarëve në DKR dhe Zyret Rajonale gjithashtu është problem dhe do të shkaktoj pengesa të mëtejme në realizimin e planeve të shitjes.
- Numri i madh i vendimeve të Qeverisë për shpronësimin dhe kthim të pronave në pronësi Komunale
- Procesi i komasacionit në Komunën e Gjakovës ku edhe pëkundër kërkesës që mos të bëhen ndryshime kadastrale bartja e pronës në emër të personave privat sipas vendimeve të komasacionit si dhe kthimi i gjendjes së mëprashme në regjistra kadastral një gjë e tillë nuk është duke ndodh.

9 DEPARTAMENTI LIGJOR

9.1 ARBITRAZHET

Agjencia, me konkretisht Departamenti Ligjor edhe gjatë vitit 2020 është angazhuar në procesin e dy arbitrazheve që janë duke u zhvilluar përkitazi me vendimet e Agjencisë ndërlidhur me dy ndërmarrje shoqërore:

9.1.1. Padia e Sharr Beteiligungs GmbH në Gjermani vs Agjencia Kosovare e Privatizimit (forumi i arbitrazhit në këtë çështje është Gjykata Permanente Ndërkombëtare e Arbitrazhit me seli në Hagë).

Në rastin e parë Agjencia është e paditur nga kompania Gjermane "Sharr Beteiligungs GmbH" e cila është pronare e Ndërmarrjes "Sharrcem" në Han të Elezit (Fabrika e Çimentos) e privatizuar në vitin 2010. Kjo kompani ka paditur AKP-në për vendimin e lëshuar nga Bordi i Drejtorëve me të cilin vendim blerësi/kompania detyrohet të paguaj vlerën prej 9.4 milion euro si çmim shtesë, ngase kompania nuk e kishte përmbushur zotimin sipas kontratës për investimin e shumës prej 35 milion euro, dhe bazuar në Kontratën për shitblerjen e aksioneve si masë penalizimi AKP-ja ka shqiptuar vendim për pagesën e pjesës së mos përmbushjes në vlerë prej 9.4 milion, vlerë kjo e përcaktuar nga auditori i jashtëm i pavarur.

Përgjatë vitit 2020 firma ligjore (Squire Patton Boggs nga Amerika) e cila e përfaqëson interesin ligjor të ndërmarrjes/ACP, i ka kryer të gjitha veprimet procedurale dhe materiale që ndërlidhen me rastin konkret, duke përfshirë mbrojtjen në padi, kundërpadinë e AKP'së në vlerë prej 35 milion euro ndaj blerësit të kësaj ndërmarrje, intervistimin dhe angazhimin e një mori dëshmitarësh të cilët në seancën e planifikuar për datat 01 mars 2021 – 05 mars 2021 të njëjtit do e mbrojnë vendimmarrjen e Agjencisë sa i përket vendimit të AKP për shqiptimin e ndëshkimeve në vlerën prej 9.4 milion euro. Po ashtu rikujtojmë se kualitetit i punës së përfaqësimit sipas kontratës së prokurimit të lidhur nga Agjencia dhe firma ligjore, ka qenë në nivelin e duhur me çka AKP deri me tani ka realizuar pagesat financiare për firmën ligjore konform kontratës në fjalë.

Sipas rregullave të Unicitralit, rregulla këto me të cilat gjykohet rasti, Tribunali i Arbitrazhit ka këtë përbërje:

1. Stephen Drymer, Kryetar.
2. Bartosz Kruzewski, Anëtar.
3. Maria Vicien Milburn, Anëtar.

9.1.2 Padia e IMING d.o.o Stobec Kroaci vs Agjencia Kosovare e Privatizimit (arbitrazhi sipas rregullave të Unicitralit pranë Odes Ekonomike të Kosovës):

Rasti i dytë i arbitrazhit ka të bëjë me Ndërmarrjen Miniera e Goleshit. Në këtë rast paditëse është kompania Kroate IMING D.O.O e cila ka paditur AKP'në për kompensim të Investimeve si dhe për fitim të humbur në vlerë prej 18 milion euro lidhur me Minierën dhe Industrinë e Magnezit "MiM Golesh".

Duhet theksuar faktin se përgjatë vitit 2020, për shkak të mungesës së firmës ligjore për t'a përfaqësuar këtë rast, i gjithë aktivitetit ligjor është mbrojtur nga ana e Departamentit Ligjor, duke përfshirë përgjigjen në njoftimin në arbitrazh, mbrojtjen në padi, veprime procedurale tjera në baza ditore, seanca gjyqësore e mbajtur në muajin shtator përkitazi me juridiksionin e lëndës, kontaktimi me institucione relevante të cilat kanë njohuri me rastin, si dhe fazës së prodhimit të dokumenteve i cili proces është nder me të rëndësishmet në procesin e arbitrazheve. Në fund të muajit dhjetor 2020, Agjencia ka arritur që përmes prokurimit publik të angazhoj firmën ligjore "Holman Fenwick" me seli në Zvicër, firmë kjo me një reputacion kredibil ndërkombëtar sa i përket çështjeve të përfaqësimit në arbitrazhe ndërkombëtare.

Tribunali i Arbitrazhit në këtë çështje përbëhet nga:

1. Luke Parsons, Kryetar.
2. Davor Babic, Anetar.
3. Virtyt Ibrahimaga, Anetar.

9.2 NJËSIA E OPINIONEVE LIGJORE DHE SHQYRTIMIT TË KONTRATAVE TË SHITJES

Njësia e Opinioneve Ligjore (NJOLSHKSH) ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike rregullore apo akte tjera juridike, shqyrtimit të kontratave të shitjes si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme.

Përmbledhja e aktiviteteve të NJOLSHKSH gjatë periudhës raportuese, është paraqitur më poshtë:

Përshkrimi	Gjithsej
Opinione Ligjore sipas formularit standard për OL;	4
Këshilla Ligjore përmes emailit;	20
Përgjigje në kërkesa të palëve;	15
Pjesëmarrje në komisionin vlerësues të prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë përkitazi me angazhimin e firmës ligjore në rastin e Arbitrazhit Kosova Petrol vs Republika e Kosovës;	1
Pjesëmarrje në komisionin punues për Ligjin e Rimëkëmbjes Ekonomike i miratuar nga Kuvendi i Kosovës;	1
Pjesëmarrje në komisionin punues të Qeverisë së Kosovës në lidhje me strategjinë dalëse për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;	1
Pjesëmarrje në komisione punuese të organizuara nga Ministria e Pushtetit Lokal në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe të tjera;	4
Numri total i draft kontratave të shqyrtuara është;	98
Numri total i rishqyrtuar i draft kontratave është;	4
Pjesëmarrje në Komisionin punues të AKP në lidhje me rishikimin e gjithë akteve nënligjore të Agjencisë.	1

9.3 NJËSIA PËR PËRFAQËSIME LIGJORE

Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

Përshkrimi	Gjithsej
Numri i përgjithshëm i lëndëve të reja të pranuar;	126
Pjesëmarrje në seanca gjyqësore;	149
Aktgjykime të pranuar;	35
Aktvendime nga gjykatat dhe organet tjera administrative të pranuar;	299
Urdhra të pranuar nga Gjykatat;	125
Ankesa dhe mjete tjera juridike të parashtruara nga AKP;	37
Përgjigje në padi;	61
Parashtrës;	110
Përgjigje në urdhra;	68
Përgjigje në ankesa/kërkesa për masë të sigurisë dhe mjete tjera juridike të parashtruara nga palët;	96
Angazhime në komisione tjera;	2
Padi të parashtruara nga AKP;	7
Ankesa për përfshirje në listën përfundimtare për 20% të pranuar;	120
Aktgjykimet e pranuar në lidhje me 20%;	13

Përshkrimi	Gjithsej
Aktvendimet e pranuar;	34
Përgjigje në ankesë për përfshirje në listën përfundimtare për 20% dhe mjete tjera juridike;	121
Urdhra;	6
Përgjigje në urdhër;	3
Parashtesa;	3

9.4 NJËSIA PËR TRAJTIMIN E ASETEVE JASHTË VENDIT

Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

- Komunikim me Oden e Avokatëve të Bosnja Hercegovinës;
- Takim me Ambasadorin e Kosovës në Republikën e Mali të Zi;
- Dorëzimi i informatës zyrtare për Ambasadën e Kosovës në Mal të Zi lidhur me astet e NSh-ve në Mal të Zi;
- Ofrimi i dëshmimeve dhe dokumentacionit relevant lidhur me pronat në Maqedoninë Veriore me të autorizuarin e AKP-së për identifikimin aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Përgatitja e termave të referencës lidhur me angazhimin e një avokati për kryerjen e shërbimeve juridike për asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore (Nsh) në Serbi;
- Pjesëmarrje në grupin punues lidhur me planin për veprim me qellim zbatimin e strategjisë nacionale për të drejtat pronësore organizuar nga zyra e OSBE dhe Ministria e Drejtësisë, (për shkak të Pandemisë me virusin Covid 19, takimi është organizuar në forme virtuale).
- Bashkëveprim me zyrtarin çështjes lidhur me përgatitjen e draftit fillestar në parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese për shpalljen pavlefshme të Gjykatës komunale në Malisheve C.nr.29/2007 date 31.10.2007, Ac nr.570/2007 datë 07.04.2010 të Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe të Kolegjit të ankesave të Dhomës e Posaçme të Gjykatës Suprem të Kosovës nr. AC-II-15-0042;
- Koordinimi i veprimeve me AL-në e NSh-së “ Integj ” Gjilan dhe palën Adnan Muratovic nga Zenica e Bosna Hercegovinës i interesuar lidhur me asetin në Sarajevë;
- Takim në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) përkitazi me krijimin e qasjes për AKP lidhur me sigurimin e të dhënave kadastrale dhe pronësore nga sistemi i regjistrave pronësor dhe kadastral të Kosovës;

3.1. Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë:

Përshkrimi	Gjithsej
Përgjigje në urdhër	5
Pjesëmarrje në seancë gjyqësore	12
Aktgjykim	1
Ankesa	6
Përgjigje në përgjigje	1
Parashtresa	16
Parashtresa elektronike	20
Aktvendime	9
Identifikimi i aseteve në Maqedoni	3
Vizite aseteve në Maqedoni	2

9.5 NJËSIA E SHKRESAVE GJYQËSORE

Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

Përshkrimi	Gjithsej
Kërkesa Pronësore	126
Kërkesa për Komision të Banesave	27
Kërkesa për paga	16
Kërkesa për kategori të tjera	69
Kërkesa për rregullat të Tenderit	4
Kërkesa për listë të punëtorëve.	118

10 DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT

Plani i punës së Departamentit të Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorë për vitin 2020 ka paraparë që njëra ndër shtyllat kryesore të angazhimit, në përputhje me rolin që ka, do të jetë në sigurimin e përkrahjes së plotë në promovimin e punës së Agjencisë, edukimin e publikut në lidhje me punën e Agjencisë si dhe hartimin dhe menaxhimin e fushatave specifike të sektorit informativ të Agjencisë. Pasi që njëra nga funksionet primare është e lidhur ngushtë me shitjen si proces, njëkohësisht është planifikuar përkrahje e plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga Agjencia si dhe promovimin dhe ruajtjen e raporteve të mira me investitorët dhe palët e interesit.

Megjithatë, situata e krijuar me shpalljen e pandemisë nga ana e OBSH-së dhe vendimet pasuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me menaxhimin e pandemisë, kanë ndikuar në funksionalizimin e planit të paraparë të punës për pjesën më të madhe të vitit 2020, sidomos pjesa që ka të bëjë me shitje të aseteve dhe promovim të këtyre shitjeve.

Për qëllime të raportimit, aktivitetet e realizuara të Departamentit të Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, janë të grupuara në përputhje me objektivat e cekura në planin e punës për vitin 2020:

Përkrahja e plotë në shpallje të Shitjeve të Aseteve dhe publikime tjera të rëndësishme

Fillimi i vitit 2020 ka filluar me intensitet të plotë në aspektin e shitjeve ku me 21 janar 2020 është bërë publikimi i Shitjes së Aseteve 54, pasuar nga shpallja e Shitjes së Aseteve 55 me 25 shkurt 2020. Megjithatë, Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në harmoni me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 15.03.2020 nr.01/21 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, shpalljes së pandemisë nga OBSH Coronavirus/Covid 19 morri vendimin emergjent për pezullimin e të gjitha procedurave duke përfshirë edhe pranimin dhe hapjen e ofertave për Shitjen e Aseteve 55, që ishte planifikuar të mbahej me 25 mars 2020. Pjesa tjetër e vitit 2020 nuk ka pasur shpallje të Shitjeve të Aseteve tjera.

Për dy shitjet e shpallura, praktikat e deritanishme të informimit publik janë aplikuar përmes aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve, në drejtim të implementimit të strategjisë së marketingut masiv në kombinim me aktivitete të marketingut direkt, në funksion të përmbushjes së qëllimit për ngritje të vizibilitetit dhe shpërndarjes sa më masive të informatës tek të gjitha palët e interesit. Aktivitetet e ndërmarra:

- Përmbledhja e materialeve relevante dhe koordinimi me zyret rajonale në lidhje me përgatitjen e shpalljeve për Shitje të Aseteve
- Realizimi i të gjitha produkteve të marketingut, përfshirë konceptimin, dizajnin dhe realizimin teknik të TV reklamave, shpalljeve të shtypura, dhe të gjitha materialeve tjera promovuese
- Publikimi i shpalljeve të Shitjeve është bërë në të gjitha gazetatat lokale, ueb faqen e AKP-së dhe përmes transmetimit të TV Reklamës.
- Personat e regjistruar në databazën e investitorëve potencial janë njoftuar mbi shpalljen e Shitjeve të Aseteve përmes postës elektronike dhe SMS shërbimit.
- Informatat rreth shpalljes së Shitjeve janë bërë edhe në mediet elektronike, me ç'rast baneri me njoftimin e shpalljes është publikuar në portalet e kontraktuara nga Agjencia.

- Transmetimi i radio reklamës është bërë edhe në radio stacionet nacionale dhe në radio stacione lokale përmes Rrjetit të Radiove Lokale, në rajonet ku ka pasur më shumë prona të përfshira në shitje. Gjithashtu, reklama në gjuhën serbe është transmetuar në lokacionet e banuara me minoritete serb folëse, për shkak të aseteve që kanë qenë në shitje në këto lokacione.
- Përgatitja e njoftimeve (ftesave) dhe komunikatave për media lidhur me lansimin e shitjeve, organizimin, koordinimin dhe mundësimin e prononcimeve për media nga përfaqësuesit e Agjencisë nga ceremonitë e shitjes së aseteve të NSh-ve në likuidim të realizuara gjatë vitit;
- Moderimi i ceremonisë së shitjes së aseteve dhe të gjitha aktivitetet tjera me interes për publikun të ndërlidhura me ditën e shitjes.

Gjithashtu, Departamenti ka vazhduar të përkrah dhe të realizoj të gjitha kërkesat e Agjencisë në lidhje me njoftimet e nevojshme për publikun, përfshirë dizajnin e raportit vjetor të Agjencisë dhe koordinimi me operatorin ekonomik për shtypjen e kopjeve fizike, përgatitjet e banerave informues për portale, realizimi i spotit informues për TV dhe banerit për portale, në përputhje me udhëzimin e OVGJS për publikimin e njoftimeve të Agjencisë etj.

Ngritja e vizibilitetit dhe promovimit të procesit të privatizimit - Promovimi i aseteve Strategjike Agjencia ka publikuar Studimin Zhvillimor “Zhvillimi Biznesor i Minierës së Goleshit”, duke vlerësuar se këto të dhëna duhet t’i bëjë të qasshme për publikun. Për këtë qëllim ka vendosur të publikoj versionin origjinal të këtij studimi në web faqen e Agjencisë, në mënyrë që të shpallë mundësitë si për institucionet vendore, ashtu edhe për investitorët e interesuar, duke prezantuar mundësitë që ofron Goleshi dhe duke veçuar mundësinë relativisht të shpejtë për kthim të investimeve. Me këtë rast është përgatitur Komunikatë për Media lidhur me publikimin e këtij studimi.

Ngritja e transparencës dhe nivelit të informimit

Tashmë është finalizuar projekti “Regjistrimi i Aseteve”, i iniciuar në vitin 2019, ku është paraparë që portfolio e aseteve të pashitura të Agjencisë të plotësohet me gjendjen reale të këtyre aseteve përmes videove të realizuara me incizime përmes dronit dhe fotografive 360°. Pjesë e këtij projekti kanë qenë mbi 700 asete të kategorisë “ndërtesa”, për të cilat tashmë Agjencia ka në dispozicion video dhe foto materiale të gjendjes aktuale.

Në shërbim të ngritjes së transparencës dhe nivelit të informimit, webfaqja e AKP-së është azhuruar dhe populluar me informata të sakta dhe në kohë reale me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Kjo përfshin lansimin e Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtoreve për shpërndarjen e 20%, raportet përfundimtare të likuidimit, komunikatave për media, raportet dhe rregulloret e AKP-së, rezultatet dhe vendimet për shitjet e Aseteve, si dhe informatave të tjera të rëndësishme.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Departamenti ka vazhduar bashkëpunimin ndërinstitucional duke u përgjigjur në kërkesat specifike, si përgatitja e të dhënave me përgjigje për Ministrinë e Bujqësisë, Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore për të dhënat për privatizimin e tokave bujqësore në Kosovë në vitin 2019. Janë përpiluar tri (3) raporte për Ministrinë e Integritetit Evropian lidhur me zbatimin e planit kombëtar për zbatim të MSA-së si dhe një sqarim lidhur me procesin e likuidimit.

Gjithashtu, Departamenti ka përgatitur të gjitha materialet e kërkuara nga Komisioni Hetimor Parlamentar për Privatizim, kopjet fizike dhe elektronike, në lidhje me materialet e shitjes për Valët e Privatizimit (60 Valë) dhe Shitjet e Aseteve (54 Shitje) periudhën nga fillimi i procesit të privatizimit (2003) e deri më 2020.

11 DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese (1 Janar – 31 Dhjetor 2020) në Departamentin e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

PAGAT

- Janë përgatitur dhe dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020;
- Është përgatitur Korniza afatmesme e shpenzimeve (KASH) për periudhën 2021-2023 (në bashkëpunim me Departamentin e Financave dhe Buxhetit);

FLUKTUIMET/ LËVIZJET E STAFIT:

- **REKRUTIMET:** Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka vazhduar me dy (2) procedura të rekrutimit të cilat janë pezulluar në vitin 2019 pas pezullimit të të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik nga Gjykata Kushtetuese;
- **DORËHEQJE:** Për arsye personale tre (3) punonjës kanë ofruar dorëheqje.
- **TRANSFERET:** Dhjetë (10) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme dhe dy (2) punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme.
- **PEZULLIM I DAKORDUAR:** Dy (2) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.
- **PENSIONIM:** Një (1) punonjës është pensionuar me rastin e përmbushjes së moshës 65 vjeçare;
- **PUSHIM LEHONIE:** 6 (gjashtë) zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë.
- **USHTRUES DETYRE:** Gjatë vitit 2020, 16 (gjashtëmbëdhjetë) zyrtarë janë caktuar ushtrues detyre në periudha të ndryshme. Arsyet dhe nevojat për caktim të ushtrues detyre kryesisht kanë të bëjnë me zëvendësimin e pozitave të mbetura të paplotësuara pas pezullimit të dakorduar të pozitave dhe krijimit të pozitave të reja sipas strukturës së re organizative.

TË TJERA:

- Janë realizuar gjithsej gjashtë (6) trajnime me ç ‘rast nga këto trajnim kanë përfituar 24 punonjës;
- Si rrjedhojë e pandemisë me COVID-19, DBNJ dhe Agjencia në përgjithësi ka pasur të pamundur realizimin e objektivave të përcaktuara me plan për vitin 2020

SFIDAT

Pandemia me COVID-19 e cila ka bërë që stafi i Agjencisë sikurse edhe në institucione të tjera të punojë kryesisht me staf esencial dhe me rotacion nga muaji mars I vitit 2020

12 DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ka për detyrë të ofroj kushte sa më të mira infrastrukturore dhe logjistike për arritjen e objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi: Njësia e Përkthimeve, Njësia e Protokollit, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Arkivit, Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësia e Transportit.

Njësia e Teknologjisë Informative:

Për shkak të shkurtimit të buxhetit nga Ministria e Financave gjatë vitit 2020, si në mjetet kapitale, ashtu edhe ato jo-kapitale (arsyeja, pandemia e koronavirusit), njësia e TI-së nuk ka arritur që t'i përmbush të gjitha objektivat e përcaktuara për këtë vit. Njësia e TI-së ka ndërmarr shumë masa tjera parandaluese, të cilat kanë rezultuar në shërbime kualitative të pandërprera dhe ndër më kryesoret mund të cekën pikat në vijim:

- Instalimi dhe konfigurimi i infrastrukturës së re “vMware vSphere 7.0 Infrastructure” me 3 serverë të rinj, si dhe serveri virtual për menaxhim - vCenter server - objektiv i përmbushur, i caktuar nga viti paraprak;
- Përmirësimi i shpejtësisë së komunikimit në rrjetet përmes instalimit të dy Switch-ave 50 portesh të rinj, objektiv ky i përmbushur, i caktuar nga viti paraprak;
- Instalimi i dhe konfigurimi i pajisjeve të reja (ndërrimi i kompjuterëve, printerëve skanerëve të vjetër) nga procesi i prokurimit (10 kompjuterë të rinj, printerë e pajisje tjera);
- Përmirësim i sistemit operativ të klientëve (Upgrade) nga Microsoft Windows 7 në Microsoft Windows 10, si dhe përmirësim i aplikacionit Microsoft Office 2007 në Microsoft Office 2013 i më shumë se 50 kompjuterëve;
- Përmirësim i sistemit operativ të serverëve (Upgrade) nga Microsoft Windows 2008 R2 në Microsoft Windows 2012 R2.

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme:

- Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike, kemi mbikëqyrur renovimet për adaptimin e një pjese të Anexit të Objektit Rilindja për të akomoduar stafin e Selisë Qendrore dhe Zyrës Rajonale të Prishtinës. Punimet janë në vazhdim dhe deri më tani kanë përfunduar rreth 70% e punimeve;
- Pas një pune 3 mujore, më 1 mars 2020 Zyra Rajonale në Gjilan, bashkë me arkiven, kanë kaluar në objekt të ri dhe shumë më komod, posaçërisht pjesa e hapësirave për zyra.

13 DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Në Departamentin e Prokurimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 janë nënshkruar **38** kontrata duke përdorur procedurat e prokurimit në vijim:

- a. Procedurë e hapur
- b. Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë
- c. Procedurë e kuotimit të çmimeve si dhe
- d. Procedurë për kontrata me vlerë minimale

Me poshtë gjeni ndarjen e kontratave sipas kategorive:

- **Kontratë për shërbime** - janë realizuar gjithsej 25
- **Kontratë për furnizime** - janë realizuar gjithsej 13

Vërejtje: Dy aktivitete të prokurimit nga viti i kaluar janë bartur në vitin 2021.

14 DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2020, aktivitetet e Komisionit kanë qenë si në vijim:

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2020
Numri i Listave Fillestare	4
Numri i Listave Finale	3
Numri i përfitueseve të 20%	14,132
Vlera e përfituar	16,501,407
Numri i vendimeve të DhPGJSK	7
Numri i ankesave të shqyrtuara	151
Ankesa të aprovuar	18
Kontrata për shitjen e Banesave të nënshkruara	5
SDR të aprovuar nga Bordi i Drejtoreve	2

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit për njësitë përkatëse, paraqiten në raportin vjetor të Agjencisë.

15 NJËSIA E NEGOCIMIT DIREKT

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 11 (njëmbëdhjetë) takime të Bordit në të cilat janë prezantuar lëndë nga NND;

- **(Janar)** Janë punuar dhe përcjell në BD 8 (tetë) Raporte Përfundimtare për shitjet me negociim direkt. Janë punuar dhe përcjell tek palët 40 fatura për shitjet me negociim direkt në vlerë prej 2,190,258;
- **(Shkurt)** Janë punuar dhe përcjell në BD 7 (shtatë) Raporte Përfundimtare dhe 45 (dyzetepesë) Raporte Rekomanduese për shitjet me negociim direkt. Po ashtu janë autorizuar disa vlerësues për vlerësime të shkallës së parë dhe super-ekspertiza (22 vlerësues). Janë pranuar 20 raporte të vlerësimit dhe të njëjtat iu janë përcjellë palëve për pranim ose refuzim të vlerësimit;
- **(Mars)** Janë punuar dhe përcjell në BD 20 (njëzetë) Raporte Përfundimtare. Janë dorëzuar te palët 12 (dymbëdhjetë) fatura. Janë pranuar përgjigje nga palët në lidhje me raportet e vlerësimit. Janë dorëzuar 7 (shtatë) kontrata të shitjes;
- **(Prill)** Janë punuar dhe përcjell në BD 7 (shtatë) Raporte Përfundimtare për shitjet me negociim direkt. Janë dorëzuar 6 (gjashtë) kontrata të shitjes;
- **(Maj)** Janë punuar dhe përcjell në BD 7 (shtatë) Raporte Përfundimtare për shitjet me negociim direkt. Janë dorëzuar 17 (shtatëmbëdhjetë) kontrata të shitjes;
- **(Qershor)** Janë në punuar Raportet Përfundimtare për lëndët të cilat i plotësojnë kushtet - 17 raporte përfundimtare, së bashku me Memon përmbledhëse. - Janë përgatitur 15 Raporte Rekomanduese me gjithsejtë 59 parashtrues, dhe Memo e Raporteve Rekomanduese përmbledhëse. Janë dorëzuar 4 kontrata të shitblerjes;
- **(Korrik)** Janë punuar dhe përcjell në BD 4 (katër) Raporte Përfundimtare për shitjet me negociim direkt dhe 7 (shtatë) Raporte Rekomanduese me gjithsejtë 7 Parashtrues. Janë dorëzuar 6 (gjashtë) kontrata të shitjes;
- **(Shtator)** Janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së (35) Raporte Rekomanduese dhe (15) Raporte Përfundimtare. Pas aprovimit të Raporteve Rekomanduese janë autorizuar vlerësuesit e pronave të paluajtshme (3 raste me 6 palë) dhe gjeodetët për vazhdimin e ekspertizave (5 raste). Janë pranuar 3 raporte të vlerësimit dhe të njëjtat janë përcjell tek palët. Janë dorëzuar tek blerësit 10 kontrata të shitjes në vlerë prej 126,950 €;
- **(Tetor)** Janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve (11) Raporte Përfundimtare me 24 parashtrues. Pas aprovimit të Raporteve Rekomanduese janë autorizuar vlerësuesit e pronave të paluajtshme (18 raste) dhe gjeodetë për vazhdimin e ekspertizave gjithsejtë (9 raste). Janë pranuar 18 raporte të vlerësimit dhe të njëjtat janë përcjell tek palët. Janë përcjell tek palët vendimet e BD dhe faturat për 30 rastet të cilat janë aprovuar me raport përfundimtar. Janë dorëzuar tek blerësit 15 kontrata të shitjes në vlerë prej 763,309 €;
- **(Dhjetor)** Janë dorëzuar për aprovim në Bordin e Drejtorëve (21) Raporte Rekomanduese dhe (6) Raporte Përfundimtare me (13) parashtrues. Janë përcjell tek palët njoftimet për aprovimin e procedurës së negociimit për (8) raste dhe faturat për pagesën e taksës administrative. Janë përcjell tek palët vendimet e BD dhe faturat për 39 rastet të cilat janë aprovuar me raport përfundimtar;

Me poshte janë të paraqitur në formë tabelare treguesit

NR.	Treguesit [veprimet]	ZR Prisht	ZR Pejë	ZR Prizren	ZR Mitro	ZR Gjilan	Numri i përgjith.
1	TË REGJISTRUARA Numri i përgjithshëm i kërkesave të regjistruara	543	328	589	154	242	1,856
2	TË SHQYRTUARA Numri i përgjithshëm i Raporteve Referuese, të shqyrtuara	272	114	127	52	98	663
3	TË APROVUARA Numri i përgjithshëm i Kërkesave të miratuara në BiD [Raportet Rekomanduese - Baza juridike e negocimit]	153	105	49	52	57	416
3.1	Numri i Kërkesave/Raporteve Referuese, të aprovuara gjatë muajit dhjetor 2020	/	/	/	/	/	0
4	TË APROVUARA Numri i Rasteve [Kërkesave] të miratuara në Bord [Raportet Përfundimtare - Aprovimi i shitjes]	136	85	49	24	11	305
4.1	Numri i Raporteve Përfundimtare - Aprovimi i shitjes të miratuara në Bord gjatë muajit dhjetor 2020	/	/	/	/	/	0
5	Numri i Kontratave të dorëzuara total	115	43	43	13	9	223
5.1	Numri i Kontratave të dorëzuara gjatë muajin dhjetor 2020	4	4	11	/	/	19
6	Numri i Kontratave në Proces (në pritje të pagesës ose proces të draftimit)	21	42	6	11	2	84
7	Numri i Rasteve [Kërkesave] të Refuzuara në BiD	3	1	/	0	/	4
8	Numri i Rasteve [Kërkesave] të Refuzuara në NND	86	46	25	0	17	174

16 NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) nuk ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2020, si pasojë e gjendjes me COVID – 19. Megjithatë për periudhën raportuese, NJAB ka arritur të finalizojë 3 aludime të brendshme, duke i ofruar Menaxhmentit rekomandime konkrete.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së për periudhën në fjalë:

1. **Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (DFB):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2020, ka zhvilluar auditimin e këtij departamenti. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda DFB-së dhe Fondeve në Mirëbesim. Janë dhënë gjithsejtë 5 rekomandime konkrete për DFB dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
2. **Auditimi i Departamentit të Marketingut Marrëdhënive me Publikun dhe Investitorë (DMMPI):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Marketingut. Qëllimi i këtij auditimi është që t'i ofrojë siguri të arsyeshme se puna e realizuar është në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe zhvillohet sipas objektivave të vendosura si dhe në një ambient të mbuluar me kontrole adekuate. Janë dhënë gjithsejtë 6 rekomandime konkrete për DMMPI dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
3. **Auditimi i Njesisë së Negocimit Direkt (NJND):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2018, ka filluar auditimin e këtij departamenti. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda këtij departamenti. Objektivat e këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të ndërlidhur me punën e Njesisë së Negocimit Direkt, që si detyrë kryesore kanë trajtimin e kërkesave të palëve lidhur me shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negociim direkt. Raporti final i këtij auditimi është shpërndarë tek Menaxhmenti në muajin Tetor. Janë dhënë gjithsejtë 11 rekomandime konkrete për NJND dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
4. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit (DP):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda këtij departamenti. Ky auditim është përfunduar në muajin nëntor 2020, megjithatë për shkak të ndikimit të COVID- 19 (mungesës në punë të stafit), raporti nuk është finalizuar;
5. **Mbajtja e takimeve të Komitetit të Auditimit:** Gjatë periudhës raportuese Komiteti i Auditimit ka mbajtur tri takime, ku janë diskutuar raportet mbi aktivitetet e NJAB-it për periudhën Janar-Tetor 2020, është aprovuar plani i punës së NJAB për vitin 2020, ka pasur diskutime mbi draft-raportet dhe raportet finale të auditimit të ZKA-së, diskutime mbi përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të NJAB-it nga Menaxhmenti, si dhe janë diskutuar çështje tjera që ndërlidhen me kontrollin e brendshëm të Agjencisë;
6. **Përgatitja e raporteve mbi aktivitetet e NJAB-it për Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB):** Duke iu referuar kërkesave ligjore, në muajin Janar, NJAB ka përgatitur dhe dorëzuar tek NJQHAB-ja raportet mbi aktivitetet e saj për vitin 2020. Po ashtu gjatë periudhës raportuese NJAB-ja ka bërë raportimin mbi aktivitetet e kryera të sajë për periudhën Janar-Dhjetor 2020;
7. **Përgatitja e planit të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021:** Gjatë periudhës raportuese është përgatitur Plan i punës së NJAB-it për vitin 2021. Ky dokumente, sipas procedurave është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe i është dërguar NJQHAB;
8. **Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) për AKP-në dhe Fondet në Mirëbesim nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA):** Gjatë periudhës raportuese, Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimin

e Pasqyrave Vjetore Financiare të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2019. Në muajin Qershor, nga ZKA-ja kemi pranuar raportet finale të auditimit të PVF-ve të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për vitin 2019. Opinioni i auditorëve për te dy auditimet është i pamodifikuar;

- 9. Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2019:** Duke iu referuar kërkesave ligjore, pas pranimi të raporteve të auditimit nga ZKA-ja, në bashkëpunim me Menaxhmentin është përgatitur Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2019. Ky plan, konform procedurave është dorëzuar tek ZKA-ja brenda afateve të përcaktuara ligjore.

17 STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

